i ri, e filloi karrierën e vet në Armeni me një thyerje kurore, u kap në flagrancë dhe sipas zakonit të vendit duhej të ekzekutohej. Pasi mundi për fat të shpëtonte duke u arratisur, ai mbyti në Paria atin e vet dhe u detyrua të fshihej.

«Dhe këtu qëlloi», — po citoj sipas përkthimit të Shotit, — «që ai mësoi edhe doktrinën e çuditshme të të krishterëve, duke u takuar në Palestinë me priftërinjtë dhe me njerëzit e ditur të kësaj feje. Dhe brenda një kohe të shkurtër ai pati aq suksese, saqë mësuesit e tij dukeshin fëmijë në krahasim me të. Ai u bë edhe profet, edhe kryeplak i komunitetit, edhe kryetar i mbledhjeve liturgjike, — me një fjalë, asgjë s'bëhej pa të; ai interpretonte shkrimet e tyre duke shkruar edhe vetë plot të tilla, aq sa, më në fund, filluan ta shikonin si një qenie të lartë, kërkonin ndihmën e tij si ligjdhënës dhe e shpallën mbrojtës të tyre (peshkop)... Për këtë (d.m.th. si të krishterë) një ditë autoritetet e kapën Proteun dhe e futën në burg... Kur ishte në pranga, të krishterët, të cilët burgosjen e tij e quanin fatkeqësi të madhe, s'lanë gjë pa bërë që ta lironin. Por kjo nuk u arrit dhe atëherë ata filluan të kujdeseshin për të në mënyrë të jashtëzakonshme. Me t'u gdhirë, plakat, gratë e veja dhe fëmijët jetimë grumbulloheshin para portës së burgut të tij; të krishterët që kishin njëfarë influence arrinin bile t'i blinin rojet e burgut dhe të kalonin net të tëra me të; ata i çonin ushqimet e veta, lexonin pranë tij librat e tyre të shenjtë, — me një fjalë, i dashuri Peregrin» (kështu e quanin ende në atë kohë) «ishte për ta të paktën një Sokrat i dytë! Bile edhe nga disa qytete të Azisë së Vogël vinin te ai të dërguarit e komuniteteve të krishtera për ta ndihmuar me ç'kishin, për ta ngushëlluar dhe për ta mbrojtur në gjyq. Është me të vërtetë e çuditshme se sa shpejt mblidhen këta njerëz sa herë që është puna për ndonjë nga bashkëbesimtarët e

tyre; për këtë ata nuk kursejnë as mund as shpenzime. Kështu, Peregrini merrte atëherë para nga të katër anët dhe burgu u bë për të burim të ardhurash të mëdha. Këtyre të mjerëve u është mbushur mendja se shpirti dhe trupi i tyre janë të pavdekshëm dhe se ata do të jetojnë në amshim; prandaj ata e shikojnë vdekjen me përbuzje dhe shumë prej tyre i jepen asaj me vetëdashje. Përveç kësaj, ligjdhënësi i tyre kryesor ua mbushi mendjen se që të gjithë ata do të jenë vëllezër, sapo të kthehen në fenë e tij, d.m.th. të heqin dorë nga perënditë greke dhe, duke adhuruar këtë sofist të kryqëzuar, do të jetojnë sipas porosive të tij. Prandaj ata përbuzin të gjitha të mirat e jashtme pa dallim dhe i zotërojnë ato së bashku — doktrinë kjo, së cilës ata i zunë besë pa prova dhe pa argumente. Dhe ja, kur vjen në mes të tyre një mashtrues i shkathët, që di të përfitojë me dinakëri nga rrethanat, ai mund të bëhet shumë shpejt i pasur, duke u tallur sheshit me këta njerëz të padjallëzuar. Sidoqoftë, Peregrini u la përsëri i lirë nga prefekti i atëhershëm i Sirisë».

Pasi përshkruhen disa aventura të mëtejshme të tij, më poshtë thuhet:

«Dhe ja që ky burrë i mirë na niset përsëri» (nga Paria) «për t'i rënë anembanë vendit; në vend të parave për shpenzime udhëtimi, ai kënaqej me mikpritjen e të krishterëve, të cilët kudo e mbronin dhe e prisnin me gjithë të mirat. Kështu u ushqye ai për njëfarë kohe. Por kur ai shkeli edhe ligjet e të krishterëve, — me sa duket, ata vunë re se ai hante edhe ndonjë gjë që ishte e ndaluar për ta, — ata e përjashtuan nga komuniteti i tyre».

Sa kujtime rinie më dalin përpara kur lexoj këtë pjesë nga Lukiani! Ja para së gjithash «profeti Albreht», i cili, duke filluar aty nga viti 1840, për disa

vjet me radhë grabiti, me plot kuptimin e fjalës, komunitetet komuniste vajtlingiane të Zvicrës; një burrë shtatmadh, i fortë, me mjekër të gjatë, i cili i ra anembanë më këmbë gjithë Zvicrës duke kërkuar dëgjues për ungjillin e tij të ri misterioz që do të shpëtonte botën, por i cili, me sa duket, ishte një ngatërrestar mjaft i padëmshëm dhe shumë shpejt vdiq. Ja dhe pasuesi i tij edhe më i padëmshëm, «doktor» Georg Kulmani nga Holshtajni, i cili përfitoi nga koha kur Vajtlingu ishte në burg për t'i kthyer në ungjillin *e vet* komunat e Zvicrës franceze, dhe për njëfarë kohe pati aq sukses, saqë bëri për vete, ndoshta, më të zotin, ndonëse më të krisurin ndër ta — August Bekerin. Kulmani u lexonte atyre leksionet që u botuan në Gjenevë më 1845 me titullin «Bota e re ose mbretëria e frymës në tokë. Shpallje». Dhe në parathënien e shkruar nga një pasues i tij (ndoshta, nga August Bekeri) thuhet:

> «Nuk ka pasur një njeri që të shprehte të gjitha vuajtjet tona, të gjitha mundimet dhe shpresat tona, — me një fjalë, të gjitha ato që preokupojnë epokën tonë në tërë thellësinë e saj... Ky njeri që pret epoka jonë, erdhi. Ai është doktor Georg Kulmani nga Holshtajni. Ai doli me doktrinën mbi botën e re, ose mbi mbretërinë e frymës në botën reale».

As që është nevoja të shtoj se në këtë doktrinë mbi botën e re s'ka asgjë tjetër veçse gjepura sentimentale nga më të zakonshmet, të veshura sipas Lamenesë me shprehje gjysmëbiblike dhe të paraqitura me arrogancën e një profeti. Kjo nuk i pengoi vajtlingianët e padjallëzuar ta mbanin në pëllëmbë të dorës këtë batakçi, siç e kishin mbajtur të krishterët aziatikë Peregrinin. Këta përkrahës ekstremë të ultrademokratizmit dhe të barazimtarisë, që ushqenin dyshime të paçrrënjosshme ndaj çdo mësuesi, gazetari dhe në përgjithësi ndaj çdo njeriu që nuk ishte zejtar, duke i quajtur si «njerëz me shkollë», që duan t'i shfrytëzojnë, e lejonin shtrembaluqin melodramatik Kulman t'ua mbushte mendjen se shpërndarjen e të mirave në «botën e re» do ta rregullojë më i urti, d.m.th. Kulmani, dhe prandaj, qysh tani, në botën e vjetër, nxënësit duhet t'ia japin këtij më të urtit të gjitha të mirat me të dy duart, kurse vetë duhet të kënaqen me thërrimet. Dhe Peregrini-Kulman jetoi i lumtur dhe me tërë të mirat në kurriz të komunitetit... për njëfarë kohe. Ç'është e vërteta, kjo nuk zgjati shumë; shtimi i pëshpëritjeve të atyre që dyshonin dhe atyre që nuk besonin, rreziku i ndjekjeve nga ana e qeverisë së kantonit të Vaadtit i dhanë fund «mbretërisë së frymës» në Lozanë, dhe Kulmani u zhduk.

Kujtdo që e ka njohur nga eksperienca periudhën fillestare të lëvizjes punëtore evropiane, do t'i kujtohen me dhjetëra shembuj të tillë. Sot teprime të tilla, të paktën në qendrat e mëdha, janë bërë të pamundura, por në ndonjë vend të humbur, ku lëvizja po fiton terren të ri, një Peregrin i tillë në miniaturë mundet ende të shpresojë për një sukses të përkohshëm, të kufizuar. Në të gjitha vendet në partinë punëtore kanë pasë depërtuar gjithfarë elementësh, të cilët s'kishin ç'të prisnin nga bota zyrtare ose të cilët tashmë e kishin luajtur rolin e tyre në të — kundërshtarë të vaksinimit kundër lirisë, përkrahës të përkores, vegjetarianë, antivivisekcionistë, mjekë natyralistë, predikues të komuniteteve të lira, komunitetet e të cilëve u shpërndanë, hartues teorish të reja mbi prejardhjen e botës, shpikës të dështuar ose të pafat, viktima padrejtësish të qena dhe të paqena, që u quajtën nga burokratët «grindavecë të këqij», budallenj të ndershëm dhe mashtrues të pandershëm; po të tillë njerëz u vinin edhe të krishterëve të parë. Të gjithë ata elementë që u liruan, d.m.th. u flakën jashtë nga procesi i shpërbërjes së botës së vjetër, binin njëri pas tjetrit në

sferën e tërheqjes së krishterimit, si e vetmja forcë që i qëndronte këtij procesi të shpërbërjes — sepse vetë ajo ishte produkt i domosdoshëm i tij — dhe e cila për këtë arsye u ruajt dhe u rrit, ndërsa elementët e tjerë nuk ishin veçse flutura të një dite. S'kishte ëndërr fantastike, marrëzi ose mashtrim që të mos depërtonte në komunitetet e reja të krishtera, të mos gjente, të paktën në disa vende dhe për njëfarë kohe, veshë të vëmendshëm dhe besimtarë të zellshëm. Dhe si komunitetet tona të para punëtore komuniste, ashtu edhe të krishterët e parë besonin shumë lehtë çdo gjë që u përgjigjej pikëpamjeve të tyre, aq sa nuk mund të themi me siguri që edhe në dhiatën tonë të re të mos jetë futur ndonjë pjesë nga «shkrimet e shumta» që hartoi Peregrini për të krishterët.

II

Kritika gjermane e biblës — e vetmja bazë shkencore deri tani e njohurive tona në fushën e historisë së krishterimit të hershëm — ka ndjekur dy drejtime.

Njëri drejtim është *shkolla e Tybingenit*, në të cilën në një kuptim më të gjerë mund të përfshihet edhe D. F. Shtrausi. Në hulumtimet kritike ajo arrin deri aty ku mund të arrijë një shkollë *teologjike*. Ajo pranon se të katër ungjijtë nuk janë tregime njerëzish që i kanë parë gjërat me sytë e tyre, por përpunime të mëvonshme shkrimesh të humbura dhe se nga kartat, që thuhet se i ka shkruar apostulli Pavël, janë autentike jo më tepër se katër etj. Ajo i fshin nga tregimi historik si të pabesueshme të gjitha mrekullitë dhe të gjitha gjërat kontradiktore, por nga gjërat e tjera ajo mundohet «të shpëtojë atë çka mund të shpëtohet ende», dhe pikërisht këtu duket shumë mirë karakteri i saj si një shkollë teologësh. Në këtë mënyrë

ajo i dha mundësi Renanit, i cili mbështetet në pjesën më të madhe mbi këtë shkollë, që, duke përdorur po të njëjtën metodë, «të shpëtojë» shumë më tepër dhe të përpiqet të na imponojë si material historikisht të vërtetë, përveç një numri të madh tregimesh nga dhiata e re, që janë të paktën të dyshimta, edhe një shumicë legjendash të tjera mbi martirët. Por, sigurisht, të gjitha ato gjëra nga dhiata e re, të cilat shkolla e Tybingenit i hedh poshtë si jo historike ose të falsifikuara, për shkencën mund të quhen të flakura përfundimisht.

Drejtimi tjetër përfaqësohet vetëm nga një njeri — nga *Bruno Baueri*. Merita e tij e madhe nuk qëndron vetëm në kritikën e pamëshirshme të ungjijve dhe të kartave të apostujve, por edhe në faktin se ai ka qenë i pari që u mor në mënyrë serioze me studimin jo vetëm të elementeve hebraike dhe greko-aleksandrinase, por edhe të elementeve thjesht greke dhe greko-romake, të cilat pikërisht ia hapën rrugën krishterimit për t'u bërë fe botërore. Legjenda se krishterimi paskej lindur përnjëherë dhe në mënyrë të gatshme nga judaizmi dhe që nga Palestina paskej pushtuar botën me dogmatikën dhe me etikën e vet tashmë të përcaktuara në vijat e tyre kryesore, — kjo legjendë qysh në kohën e Bruno Bauerit nuk mund të mbrohej më; ajo mund të vegjetojë ende vetëm në fakultetet teologjike dhe midis njerëzve që duan «ta ruajnë fenë për popullin», qoftë edhe në dëm të shkencës. Ndikimi shumë i madh i shkollës aleksandrine të Filonit dhe i filozofisë vulgare greko-romake — i filozofisë së Platonit dhe veçanërisht i filozofisë stoike — mbi krishterimin, i cili në kohën e Konstantinit u bë fe zyrtare, nuk është përcaktuar ende në të gjitha hollësitë, por që ka pasur një ndikim të tillë, kjo është provuar dhe kjo është kryesisht meritë e Bruno Bauerit; ai provoi në përgjithësi se krishterimi nuk u importua nga jashtë, nga Judea dhe iu imponua botës greko-romake, por se ai — të paktën në formën e tij si fe botërore — është

produkti më karakteristik i kësaj bote. Natyrisht, Baueri, si të gjithë ata që luftojnë me paragjykimet e rrënjosura, e kaloi masën në këtë drejtim. Për të përcaktuar edhe në bazë të dokumenteve të letërsisë ndikimin që ushtroi Filoni dhe veçanërisht Seneka mbi krishterimin që po lindte, si dhe për t'i paraqitur shkrimtarët e dhiatës së re si plagjiatorë të vërtetë të filozofëve të mësipërm, Bauerit iu desh ta çonte lindjen e fesë së re gjysmë shekulli përpara, të flakte njoftimet kontradiktore të historianëve romakë dhe përgjithësisht t'i jepte vetes liri të madhe në paraqitjen e historisë. Sipas mendimit të tij, krishterimi, si i tillë, lindi vetëm në kohën e Flavëve, ndërsa letërsia e dhiatës së re — vetëm në kohën e Adrianit, të Antoninit dhe të Mark Aurelit. Si pasojë, te Baueri nuk ka më as edhe një bazë historike për tregimet e dhiatës së re mbi Jezuin dhe dishepujt e tij; këto tregime shndërrohen në legjenda, në të cilat fazat e brendshme të zhvillimit dhe lufta fetare brenda komuniteteve të para u vishen disa individëve pak a shumë të trilluar. Sipas Bauerit, vendlindja e fesë së re nuk janë Galileja dhe Jerusalemi, por Aleksandria dhe Roma.

Pra, në qoftë se shkolla e Tybingenit në pjesën e historisë dhe të letërsisë së dhiatës së re, që ajo nuk kritikoi, na dha maksimumin e fundit të asaj që shkenca e sotme mund ta pranojë ende si të diskutueshme, Bruno Baueri na jep maksimumin e asaj që ajo mund të kritikojë. Midis këtyre dy caqeve qëndron e vërteta reale. Me të dhënat që kemi sot, si zor që ajo të mund të përcaktohet. Zbulimet e reja, sidomos në Romë, në Lindje dhe para së gjithash në Egjipt, do të na japin në këtë drejtim shumë më tepër se çfarëdo kritike.

Por, megjithatë, në dhiatën e re ka një libër të vetëm, për të cilin koha se kur është shkruar mund të përcaktohet me saktësi deri në disa muaj: ai ka qenë shkruar, me sa duket, midis qershorit të vitit 67 dhe janarit ose prillit të vitit 68; pra, ky libër u përket

kohëve më të hershme të krishterimit dhe pasqyron pikëpamjet e të krishterëve të atëhershëm me vërtetësinë më naive dhe me gjuhën idiomatike përkatëse; prandaj ai, sipas mendimit tim, ka më tepër rëndësi për përcaktimin e thelbit të vërtetë të krishterimit të hershëm sesa të gjithë librat e tjerë të dhiatës së re, teksti i të cilëve, në formën që ka arritur deri te ne, është shkruar shumë më vonë. Ky libër është e ashtuquajtura Zbulesë e Joanit; dhe meqenëse ky libër, që duket si më i errëti në të gjithë biblën, tani në saje të kritikës gjermane është bërë më i kuptueshmi dhe më i qarti, unë dëshiroj t'u flas për të lexuesve të mi.

Mjafton t'i hedhësh një sy të shpejtë këtij libri që të bindesh se sa i ekzaltuar ishte jo vetëm autori i tij, por edhe «ambienti rrethues», në të cilin ai ka vepruar. Zbulesa, për të cilën po flasim, nuk është një fenomen i veçuar për llojin dhe për epokën e vet. Duke filluar që nga viti 164 para erës sonë, kur është shkruar i pari libër që ka arritur deri në ditët tona, i ashtuquajturi libër i Danielit, dhe pothuajse deri në vitin 250 të erës sonë, që është data e përafërt e «Carmen»-it të Komodianit[129], Renani llogarit jo më pak se 15 «apokalipse» klasike që kanë arritur deri në ditët tona, pa llogaritur imitimet e mëvonshme. (Po përmend Renanin, sepse libri i tij njihet më tepër edhe jashtë rrethit të specialistëve dhe, përveç kësaj, edhe kuptohet më lehtë.) Kjo ishte një kohë kur edhe në Romë edhe në Greqi, dhe shumë më tepër në Azinë e Vogël, në Siri dhe në Egjipt, çdo përzierje aspak kritike e paragjykimeve më trashanike të popujve më të ndryshëm pranohej menjëherë dhe plotësohej pastaj me gënjeshtra të devotshme dhe sharlataneri të hapët; një kohë kur një rol të madh luanin mrekullitë, ekstazat, vizionet, hijet, fallet për të ardhmen, alkimia, kabala[130] dhe gjepura të tjera mistike. Kjo ishte atmosfera në të cilën lindi krishterimi i hershëm, dhe për më tepër lindi midis njerëzve të një klase, e cila ishte më e gatshme

se çdo tjetër për t'i mirëpritur këto fantazi mbinatyrore. Jo më kot në Egjipt gnostikët[131] e krishterë në shekullin e dytë të erës së re, siç e provojnë, krahas burimeve të tjera, edhe papiruset e Lejdenit, ishin dhënë me zell të madh pas alkimisë dhe futnin në doktrinat e tyre pikëpamje alkimiste. Ndërsa *matematici** kaldejas dhe hebrej, të cilët, sipas Tacitit, u dëbuan dy herë — në kohën e Klaudit dhe pastaj në kohën e Vitelit — nga Roma, sepse ishin dhënë pas magjisë, merreshin vetëm me një lloj gjeometrie, e cila, siç do ta shohim, përbën thelbin e Zbulesës së Joanit.

Përveç kësaj, duhet të shtojmë edhe këtë. Të gjitha apokalipset kujtojnë se kanë të drejtë të gënjejnë lexuesit e tyre. Ato jo vetëm që, në përgjithësi, janë shkruar nga njerëz krejt të ndryshëm, të cilët në pjesën më të madhe kanë jetuar shumë më vonë se autorët e tyre imagjinarë, si, për shembull, libri i Danielit, libri i Enohut, apokalipset e Ezdrës, të Baruhut, të Judës etj., librat e Sibilës, por ato, përveç kësaj, profetizojnë gjithnjë ngjarje që kanë ndodhur prej kohësh dhe të cilat ai që i ka përpiluar i di fort mirë. Kështu, autori i librit të Danielit në vitin 164, pak kohë para vdekjes së Antiok Epifanit, vë në gojën e Danielit, që gjoja paska jetuar në epokën e Nabukodonozorit, profecinë mbi lulëzimin dhe rënien e Perandorisë Persiane dhe asaj maqedonase dhe fillimin e Perandorisë botërore Romake, me qëllim që me këtë provë të fuqisë së tij profetike ta bëjë lexuesin të besojë profecinë e fundit se populli i Izraelit do t'i kapërcejë të gjitha vuajtjet dhe, më në fund, do të fitojë. Pra, në qoftë se Zbulesa e Joanit do të ishte me të vërtetë vepër e autorit që përmendet në të, ajo do të ishte i vetmi përjashtim në gjithë letërsinë apokaliptike.

Joani, që paraqitet si autori i saj, sidoqoftë ka

* — matematikanët. *Red.*

qenë njeri shumë i nderuar midis të krishterëve të Azisë së Vogël. Për këtë dëshmon toni i kartave, drejtuar të shtatë komuniteteve. Pra, ka mundësi që ky të jetë apostulli Joan, ekzistenca historike e të cilit nuk dihet me siguri, por megjithatë ka shumë të ngjarë të jetë e vërtetë. Dhe sikur autori të ketë qenë me të vërtetë ky apostull, kjo do ta përforconte pikëpamjen tonë. Kjo do të ishte prova më e mirë se krishterimi i këtij libri është më të vërtetë krishterimi i hershëm. Por duhet të shtojmë se Zbulesa, me sa duket, nuk i përket po atij autori që ka shkruar ungjillin ose tri kartat, të cilat gjithashtu i vishen Joanit.

Zbulesa përbëhet nga një serë vizionesh. Në vizionin e parë shfaqet Krishti, i veshur kryeprift; ai kalon midis shtatë llambadhesh zjarri të ndezura që përfaqësojnë shtatë komunitetet e Azisë dhe i dikton «Joanit» kartat drejtuar shtatë «engjëjve» të këtyre komuniteteve. Që në fillim këtu del qartë ndryshimi midis *këtij* krishterimi dhe fesë botërore të kohëve të Konstantinit, të formuluar nga koncili i Nikesë. Trinia e shenjtë jo vetëm që është fare e panjohur, por këtu ajo është e pamundur. Në vend të *një* fryme të shenjtë të mëvonshme, këtu kemi *«shtatë* frymë të perëndisë», të ndërtuara nga rabinët në bazë të Isaisë, kap. XI, vargu 2. Krishti është i biri i perëndisë, të nisurit dhe të mbaruarit, alfa dhe omega, por nuk është aspak vetë zoti ose i barabartë me zotin; përkundrazi, ai është «fillimi i *krijesës* së zotit», pra një emanacion i amshuar i zotit, por i nënshtruar ndaj zotit, si dhe të shtatë frymët e lartpërmendura. Në kap. XV, vargu 3, martirët këndojnë në qiell «këngën e Moisiut, robit të zotit, dhe këngën e qengjit», për t'i thurur lavdi zotit. Pra, këtu Krishti jo vetëm që del si i nënshtruar ndaj zotit, por bile deri diku është vënë në një shkallë me Moisiun. Krishti u kryqëzua në Jerusalem (XI, 8), por u ngjall (I, 5, 18); ai është «qengji» që u bë fli për mëkatet e botës dhe me gjakun e tij u lanë përpara zotit mëka-

tet e besimtarëve të të gjitha fiseve dhe të të gjitha gjuhëve. Këtu gjejmë atë ide kryesore, në saje të së cilës krishterimi i hershëm mundi të bëhej fe botërore. Në atë kohë të gjitha fetë e semitëve dhe të evropianëve kishin një pikëpamje të përbashkët, sipas së cilës perënditë, të fyera nga veprimet e njerëzve, mund të zbuten me flijime; ideja e parë themelore revolucionare e krishterimit (e marrë nga shkolla e Filonit) ishte se për të gjithë besimtarët me një flijim vullnetar të madh të një ndërmjetësi janë larë një herë e përgjithmonë mëkatet e të gjitha kohëve dhe të të gjithë njerëzve. Për këtë arsye nuk kishte më nevojë për të bërë këtej e tutje asnjë flijim dhe njëkohësisht nuk kishte më arsye për të zhvilluar shumë rite fetare që bëheshin më parë; por çlirimi nga ritet, të cilat i vështirësonin ose i bënin të pamundura marrëdhëniet me njerëzit e besimeve të tjera, ishte kushti i parë i fesë botërore. Dhe megjithatë, zakoni i flijimit ishte rrënjosur aq thellë në popull, saqë katolicizmi, i cili mori aq shumë nga paganët, e pa të nevojshme t'i përshtatej këtij zakoni, duke futur të paktën kurbanin simbolik gjatë meshës.

Përkundrazi, në librin që po shqyrtojmë, nuk thuhet as edhe gjysmë fjale për dogmën e mëkatit të parë.

Por gjëja më karakteristike në këto karta, si dhe në të gjithë librin është se autorit kurrë dhe në asnjë vend nuk i shkon ndër mend ta quajë veten ose bashkëbesimtarët e tij ndryshe veçse *judej*. Sektantët e Smirnes dhe të Filadelfisë, kundër të cilëve lufton ai, i qorton kështu: «Thonë për vetëhen'e tyre se janë judej, edhe nuk janë, por janë një mbledhje e Satanajt»; për sektantët e Pergamit thuhet se shkojnë pas doktrinës së Balaamit, i cili e paskej mësuar Balakun të kobonte *bijtë e Izraelit*, që të hanin kafshët që u bëheshin fli idhujve dhe të kurvëronin. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë me të krishterë të vetëdijshëm, por me njerëz që e paraqesin veten si judej; natyrisht, judaizmi

i tyre është një shkallë e re zhvillimi në krahasim me judaizmin e mëparshëm, por pikërisht për këtë arsye ai është i vetmi judaizëm i vërtetë. Prandaj kur paraqiten shenjtorët përpara fronit të zotit, në fillim vijnë 144 000 judej, nga 12 000 prej çdo fare, dhe vetëm pastaj masa e panumërt e paganëve që ishin kthyer në këtë judaizëm të përtëritur. Ja se sa pak e kuptonte ende autori ynë në vitin 69 të erës sonë se ai ishte përfaqësuesi i një faze krejt të re të zhvillimit fetar, e cila do të bëhej një nga elementet më revolucionare në historinë e mendjes njerëzore.

Pra, siç e shohim, krishterimi i asaj kohe, që nuk e kishte fituar ende vetëdijën e vetvetes, ishte larg si qielli me Tokën nga feja botërore e mëvonshme e koncilit të Nikesë, e fiksuar në dogma; atje ai na paraqitet krejt ndryshe. Kurse këtu ai nuk ka as dogmat as etikën e krishterimit të mëvonshëm; por këtu është vetëdija se lufta po bëhet kundër një bote të tërë, dhe se kjo luftë do të kurorëzohet me fitore; është gëzimi i luftës dhe besimi në fitoren, të cilat të krishterët e sotëm i kanë humbur fare dhe të cilat sot i gjejmë vetëm në polin tjetër të shoqërisë — te socialistët.

Me të vërtetë, lufta kundër një bote, e cila në fillim ishte e gjithëfuqishme, dhe njëkohësisht lufta e novatorëve midis tyre janë njëlloj karakteristike si për të krishterët e hershëm, ashtu edhe për socialistët. Të dyja këto lëvizje të mëdha nuk janë krijuar nga udhëheqësit dhe nga profetët, ndonëse që të dyja kanë pasur shumë profetë, ato që të dyja janë lëvizje masash. Dhe lëvizjet e masave në fillim janë medoemos konfuze; janë konfuze, sepse çdo mendim i masave në fillim është kontradiktor, i paqartë, i palidhur, por ato janë konfuze edhe për shkak të rolit që luajnë në to në fillim profetët. Ky konfuzion shfaqet në lindjen e sekteve të shumta që luftojnë kundër njëri-tjetrit të paktën po me aq tërbim, sa edhe kundër armikut të jashtëm të përbashkët. Kështu ka qenë në kohën e

krishterimit të hershëm, kështu ka qenë në fillim edhe në lëvizjen socialiste, sado që t'i dëshpëronte një gjë e tillë ata filistinë dashamirë që predikonin unitetin atje ku nuk mund të kishte kurrfarë uniteti.

Mos vallë Internacionalja u bashkua nga një dogmë e vetme? Përkundrazi. Atje kishte komunistë të traditës franceze të kohës para vitit 1848, edhe ata me nuanca të ndryshme; komunistë të shkollës vajtlingiane, si edhe të tjerë — nga Lidhja e ringjallur e Komunistëve; prudonistë, të cilët mbizotëronin në Francë dhe në Belgjikë; blankistë; ishte partia punëtore gjermane; më në fund, kishte bakunistë anarkistë, të cilët për një kohë mbizotëruan në Spanjë dhe në Itali, — dhe këto ishin vetëm grupet kryesore. Që nga koha e themelimit të Internacionales u desh plot një çerek shekulli që të bëhej kudo dhe përfundimisht ndarja me anarkistët dhe të mund të arrihej të paktën uniteti i pikëpamjeve ekonomike më të përgjithshme. Dhe kjo, në një kohë kur ka të tilla mjete komunikacioni, si ato që kemi sot, kur ka hekurudha, telegrafe, qytete industriale vigane, një shtyp si ai yni dhe mbledhje popullore të organizuara.

Edhe të krishterët e parë ishin të përçarë në sekte të panumërta, dhe kjo pikërisht shërbeu si mjet për të ngjallur diskutime dhe për të arritur në këtë mënyrë, më në fund, unitetin. Qysh në këtë dokument të krishterë që po shqyrtojmë dhe i cili, pa dyshim, është më i lashti, ne e gjejmë këtë përçarje dhe autori ynë ngrihet kundër saj po me atë tërbim të pamëshirshëm, me të cilin sulmon edhe gjithë botën e jashtme të zhytur në mëkate. Këtu kemi, para së gjithash, nikollaitët në Efes dhe në Pergam; pastaj, në Smirne dhe në Filadelfi — ata që thonë për veten e tyre se janë judej, edhe nuk janë, por janë një mbledhje e Satanait; në Pergam — ithtarët e doktrinës së pseudoprofetit që quhet Balaam; në Efes — ata që thonë për veten e tyre se janë apostuj, por që në të vërtetë s'janë; më

në fund, në Tiatir — ithtarët e pseudoprofeteshës së quajtur Jezabela. Më tepër hollësi për këto sekte nuk dimë, vetëm për ithtarët e Balaamit dhe të Jezabelës thuhet se hanin kafshët që u bëheshin fli idhujve dhe kurvëronin. Të pesë këto sekte mundoheshin t'i paraqisnin si të krishterë ithtarët e Pavlit, dhe të gjitha këto karta — si karta të të ashtuquajturve Balaam dhe «Nikollai» kundër Pavlit, pseudoapostullit. Në lidhje me këtë Renani ka mbledhur argumente që nuk janë aspak bindëse, «Sh'Pavli», Paris, 1869, f. 303-305, 367-370. Të gjitha ato përmblidhen në përpjekjen për t'i shpjeguar këto karta duke u nisur nga Punët e apostujve dhe nga të ashtuquajturat Karta të Pavlit, d.m.th. vepra që sidoqoftë, në formën e tyre të tanishme janë shkruar të paktën 60 vjet më vonë se Zbulesa, kështu që faktet përkatëse, që përmenden në to, jo vetëm që janë më se të dyshimta, por janë edhe krejt në kundërshtim me njëri-tjetrin. Por ajo që ka rëndësi vendimtare është se autorit tonë nuk mund t'i binte në mendje ta quante të njëjtin sekt me pesë emra të ndryshëm, duke përdorur dy emra vetëm për Efesin (pseudoapostujt dhe nikollaitët) edhe dy për Pergamin (balaamitët dhe nikollaitët), dhe çdo herë në mënyrë shumë të qartë, si dy sekte të ndryshme. Por nuk mund të mohohet mundësia që në këto sekte të bënin pjesë edhe njerëz, të cilët sot do të mund t'i quanin ithtarë të Pavlit.

Në të dyja rastet, kur autori hyn në hollësira, tërë akuza e tij është se hanin kafshët që u bëheshin fli idhujve dhe kurvëronin — dy pika, për të cilat judejtë — si të lashtët, ashtu edhe judejtë e krishterë — haheshin vazhdimisht me paganët që ishin kthyer në judaizëm. Mishi i flijimeve pagane jo vetëm që shtrohej nëpër tryeza, ku ishte e pahijshme të mos haje dhe bile mund të ishte e rrezikshme, por edhe shitej në tregjet publike, ku nuk mund ta dalloje nëse ishte haram apo jo. Me kurvërim po ata judej kuptonin jo

vetëm marrëdhëniet seksuale jashtë martesës, por edhe martesën e ndaluar nga ligji i judejve midis personave që kishin njëfarë afërie gjaku, si edhe martesën midis judejve dhe paganëve; pikërisht këtë kuptim i japin zakonisht kësaj fjale në kap. XV, vargjet 20 dhe 29 të Punëve të apostujve. Por Joani ynë ka pikëpamjen e vet edhe për ato marrëdhënie seksuale që u lejohen judejve ortodoksë. Në kap. XIV, vargu 4, ai flet për 144 000 judejtë në qiej: «Këta janë ata që nuk u përlyen me gra, sepse janë virgjër». Dhe me të vërtetë, në qiejt e Joanit tonë nuk ka asnjë grua. Duket se ai bënte pjesë në atë rrymë që haset shpesh edhe në shkrimet e tjera të krishterimit të hershëm, e cila marrëdhëniet seksuale në përgjithësi i quante mëkat. Po të kemi parasysh edhe se Romën ai e quan kurvë të madhe, me të cilën kurvëronin mbretërit e botës, duke u dehur nga vera e kurvërisë së saj, dhe se tregtarët romakë pasuroheshin në saje të shthurjes së saj të madhe, ne nuk do të mund ta marrim në kartat fjalën e mësipërme në atë kuptim të ngushtë që do të dëshironin t'i jepnin asaj teologët apologjetë, për të vërtetuar kështu edhe pjesë të tjera të dhiatës së re. Përkundrazi, këto pjesë të kartave na tregojnë qartë një fenomen që është i përbashkët për të gjitha epokat e tronditjeve të thella, dhe pikërisht se krahas me të gjitha pengesat e tjera lëkunden edhe marrëdhëniet tradicionale të lidhjeve seksuale. Në shekujt e parë të krishterimit krahas me asketizmin, që mortnon trupin, shfaqet mjaft shpesh edhe tendenca për ta përhapur lirinë e krishterë edhe në fushën e lirisë pak a shumë të pakufizuar të marrëdhënieve midis burrit dhe gruas. Po kështu ka ndodhur edhe në lëvizjen socialiste të sotme. Ç'tmerr të pabesueshëm ngjalli në vjetët 1830-1840 në Gjermaninë e atëhershme, në këtë «dhomë të përshpirtshme fëmijësh», *«réhabilitation de la chair»** i Sen-Simonit,

* — «reabilitimi i trupit». *Red.*

që në përkthimin gjermanisht u shndërrua në «rivendosje të të drejtave të trupit»! Por më tepër nga të gjithë u tmerruan ato shtresa fisnike që sundonin atëherë (në atë kohë te ne nuk kishte ende klasa), të cilat nuk mund të jetonin as në Berlin as në çifligjet e tyre, pa rivendosur vazhdimisht të drejtat e trupit të vet! Ç'do të thoshin këta burra të mirë, po ta kishin njohur edhe Furjenë, i cili parashikonte për trupin liri edhe më të mëdha! Me kapërcimin e utopizmit këto ekstravaganca dalngadalë ua lanë vendin koncepteve më racionale dhe në të vërtetë shumë më radikale; dhe qëkurse Gjermania nga «dhomë e përshpirtshme fëmijësh», siç e pat quajtur Hajneja, u bë qendër e lëvizjes socialiste, — me zemërimin hipokrit të shtresave të përshpirtshme mondane filluan vetëm të talleshin.

Kjo është e gjithë përmbajtja e kartave, që ka të bëjë me dogmat. Në pjesën tjetër ato i nxisin bashkëbesimtarët e tyre të bëjnë një propagandë të zellshme, ta shpallin haptazi dhe me krenari besimin e tyre përpara kundërshtarit, të luftojnë pa u lodhur kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm, — dhe përderisa kanë këtë përmbajtje, ato mund të ishin shkruar fare mirë edhe nga ndonjë entuziast i Internacionales me prirje profetike.

III

Kartat nuk janë veçse hyrja e temës së vërtetë të thirrjes së Joanit tonë, drejtuar shtatë komuniteteve të Azisë së Vogël, e nëpërmjet tyre edhe pjesës tjetër të judaizmit të reformuar të vitit 69, prej të cilit më vonë u zhvillua krishterimi. Dhe këtu ne hyjmë në thelbin e krishterimit të hershëm.

Nga ç'njerëz rekrutoheshin të krishterët e parë? Kryesisht në mes të «të munduarve dhe të shtypurve»,

që bënin pjesë në shtresat më të ulëta të popullit, pikërisht ashtu si i ka hije një rryme revolucionare. Po nga ç'njerëz përbëheshin këto të fundit? Në qytet — nga njerëz të lirë që kishin rënë nga dynjallëku, nga gjithfarë njerëzish, si *mean whites** në shtetet skllavopronare të Jugut dhe endacakët evropianë ose aventurierët e porteve koloniale dhe kineze, pastaj nga skllevër të liruar ose kryesisht nga skllevër; në latifundet e Italisë, të Sicilisë, të Afrikës — nga skllevër; në fshatrat e provincave — nga fshatarë të vegjël që zhyteshin gjithnjë më thellë në skllavërinë e borxheve. Nuk kishte absolutisht asnjë rrugë të përbashkët për çlirimin e të gjithë këtyre elementëve. Për të gjithë ata parajsa e humbur ishte diçka që i përkiste së kaluarës; për të lirët që kishin rënë nga dynjallëku ajo ishte polisi i dikurshëm, që ishte njëkohësisht edhe qyteti edhe shteti, në të cilin të parët e tyre patën qenë dikur qytetarë të lirë; për skllevërit robër lufte — jeta e lirë para se të binin rob dhe para se të skllavëroheshin; për fshatarët e vegjël — rendi fisnor i zhdukur dhe zotërimi i përbashkët i tokës. Të gjitha këto i fshiu nga faqja e dheut grushti i hekurt rrafshues i pushtuesit romak. Grupet shoqërore më të mëdha që arriti antikiteti ishin fisi dhe bashkimi i fiseve të afërta; te barbarët ato ishin organizuar sipas lidhjes së gjakut, ndërsa te grekët dhe te italikët, që kishin ndërtuar qytete, — në poliset që përfshinin një ose disa fise të afërta. Filipi dhe Aleksandri i dhanë gadishullit helenik unitetin politik, por me kaq nuk ishte krijuar ende kombi grek. Formimi i kombeve u bë i mundur vetëm si rezultat i rënies së sundimit botëror romak. Ky sundim u dha fund një herë e përgjithmonë bashkimeve të vogla; forca ushtarake, organizimi gjyqësor romak, aparati romak i tatimeve e shkatërruan fare organizimin tradicional të brendshëm. Humbjes së pavarësisë

* — të bardhët prej shtrese të ulët. ***Red.***

dhe të organizimit të veçantë iu shtua edhe grabitja brutale nga ana e autoriteteve ushtarake e civile, të cilat në fillim u rrëmbenin të mundurve thesaret e tyre dhe pastaj ua jepnin po atyre hua me fajde, që të mund të paguanin taksa të reja. Barra e tatimeve dhe nevoja për para, e shkaktuar prej saj në krahinat me ekonomi thjesht natyrore ose kryesisht natyrore, i bënin fshatarët gjithnjë më tepër skllevër të fajdexhinjve, krijonin dallime të mëdha pasurore, pasuronin të pasurit dhe katandisnin në mjerim të plotë të varfrit. Çdo kundërshtim nga ana e këtyre apo atyre fiseve ose qyteteve të vogla ndaj fuqisë vigane botërore të Romës ishte i kotë. Cila ishte rrugëdalja, cili ishte shpëtimi për të skllavëruarit, të shtypurit dhe të mjeruarit — një rrugëdalje e përbashkët për të gjitha këto grupe të ndryshme njerëzish me interesa të huaja ose bile të kundërta me njëri-tjetrin? E megjithatë, gjetja e një rrugëdaljeje ishte e domosdoshme, që një lëvizje revolucionare e madhe t'i përfshinte që të gjithë.

Kjo rrugëdalje u gjet. Por jo në këtë botë. Në kushtet e atëhershme rrugëdalja mund të gjendej vetëm në fushën e fesë. Dhe atëherë u hap një botë e re. Ekzistenca e mëtejshme e shpirtit pas vdekjes së trupit dalngadalë u bë kudo në botën romake kredoja e pranuar nga të gjithë. Po ashtu u përhap kudo gjithnjë më tepër ideja se shpirtrat e të vdekurve i pret njëfarë shpërblimi ose ndëshkimi për ato që kanë bërë në Tokë. Sa për shpërblimin, kjo gjë, natyrisht, ishte mjaft e pasigurt; njerëzit e lashtë ishin prej vetiu tepër materialistë, që të mos e çmonin jetën në Tokë shumë më tepër se mbretërinë e hijeve; jetën në atë botë grekët e quanin më tepër si një fatkeqësi. Por ja që doli krishterimi, i cili mbajti një qëndrim serioz ndaj shpërblimeve dhe ndëshkimeve në atë botë, krijoi qiellin dhe ferrin, dhe u gjet rrugëdalja që do t'i çonte të munduarit dhe të shtypurit nga kjo botë plot vuajtje e mjerime drejtpërsëdrejti në parajsën e am-

shuar. Dhe me të vërtetë vetëm duke ngjallur shpresën për një shpërblim në atë botë mund të ngrihej mohimi i kësaj bote dhe asketizmi i doktrinës stoike të Filonit në shkallën e parimit etik të një feje të re botërore, të aftë për të tërhequr masat e shtypura të popullit.

Por kjo parajsë qiellore nuk u hapet besimtarëve menjëherë pas vdekjes. Do të shohim se mbretëria e zotit, kryeqyteti i së cilës është Jerusalemi i ri, fitohet dhe zbulohet vetëm pas një lufte të ashpër me forcat e ferrit. Por në përfytyrimin e të krishterëve të parë kjo luftë nuk do të vononte. Joani ynë që në fillim e karakterizon librin e tij si zbulesë të gjërave që «duhetë të bënenë për *së çpejti*»; fill pas kësaj, në vargun 3, ai lajmëron: «Lum ay që këndon, edhe ata që dëgjonjënë fjalët' e kësaj profitie, sepse *koha është e afërë*»; Krishti e urdhëron t'i shkruajë komunitetit të Filadelfisë: «Ja tek vinj *çpejt*». Dhe në kapitullin e fundit engjëlli thotë se ai i ka treguar Joanit sa «duhetë të bënenë për *së çpejti*» dhe e urdhëron atë: «Mos vulosç fjalët'e profitis' së kësaj vivlie; sepse koha *është afërë*» dhe Krishti vetë thotë dy herë (vargu 12 dhe vargu 20): «Ja tek vinj *çpejt*». Më poshtë do të shohim se sa shpejt pritej kjo ardhje.

Vizionet apokaliptike, që na tregon pastaj autori, në pjesën më të madhe janë kopjuar nga modele më të hershme. Ato janë marrë pjesërisht nga profetët klasikë të dhiatës së vjetër, sidomos nga Jezekiili, pjesërisht nga apokalipset e mëvonshme të judejve, të hartuara sipas librit të Danielit, veçanërisht nga libri i Enohut, i cili atëherë ishte shkruar të paktën pjesërisht. Kritika e ka gjetur me hollësitë më të mëdha se nga e ka marrë Joani ynë çdo tablo, çdo profeci të tmerrshme, çdo fatkeqësi që u dërgohet nga lart njerëzve që s'besojnë, me një fjalë, gjithë materialin e librit të tij; pra, Joani jo vetëm që tregon një mungesë të madhe talenti, por na tregon gjithashtu në mënyrë të qartë se ai nuk i ka jetuar as në imagjinatën e vet

ekstazat dhe vizionet e pretenduara, ashtu siç i përshkruan.

Renditja e këtyre vizioneve shkurtimisht është kjo. Në fillim Joani sheh zotin të ulur mbi fron duke mbajtur në dorë një libër të vulosur me shtatë vula, dhe përpara tij — qengjin (Krishtin) që e patën mbytur, por u ngjall dhe u quajt i denjë të heqë vulat. Kur hiqen ato, ndodhin gjithfarë gjërash të tmerrshme. Kur hiqet vula e pestë, Joani sheh nën altarin e zotit shpirtrat e martirëve të krishterë, të vrarë për fjalën e zotit, dhe ata thërrisnin me zë të lartë: «Gjer kur, o zot, nuk gjykon edhe nuk merr çpagiminë për gjakun tënë nga ata që rrinë mbi dhet?» Pas kësaj atyre u japin rroba të bardha dhe i bindin të presin edhe pak, sepse duhet të vriten edhe më shumë martirë.

Pra, këtu nuk thuhet ende as edhe një fjalë për «fenë e dashurisë», nuk thuhet: «Duajini armiqtë tuaj, bekoni ata që ju urrejnë» etj., këtu predikohet hakmarrja e hapët, hakmarrja e shëndoshë, e ndershme kundër ndjekësve të të krishterëve. Dhe kështu është në të gjithë librin. Sa më tepër afrohet kriza, sa më të shpeshta bëhen mjerimet dhe ndëshkimet që vijnë nga qielli, aq më me gëzim njofton Joani ynë se një shumicë e madhe njerëzish nuk duan akoma të pendohen për mëkatet e tyre, se ata duhet t'i fshikullojë përsëri kamxhiku i zotit, se Krishti duhet t'i kullosë ata me shkop të hekurt dhe t'i shtypë në mokrën e tërbimit dhe të zemërimit të zotit të gjithëpushtetshëm, por se mohuesit e zotit prapëseprapë do të ngulin këmbë në thellësinë e zemrave të tyre. Kjo është vetëdija e natyrshme, dhe e zhveshur nga çdo hipokrizi, e faktit se bëhet luftë dhe se *à la guerre comme à la guerre**.

Kur hiqet vula e shtatë, shfaqen shtatë engjëj me bori; sa herë që i bie ndonjëri prej tyre borisë, shfaqen shenja të tjera të tmerrshme. Pasi i bie borisë en-

* — në luftë duhet vepruar si në luftë. *Red.*

gjëlli i shtatë, dalin në skenë shtatë engjëj të tjerë me shtatë kupat e zemërimit të zotit, të cilat derdhen mbi tokë; përsëri mjerime dhe ndeshkime të tjera, në thelb një përsëritje e lodhshme e asaj që është thënë shumë herë. Pastaj vjen gruaja Babiloni, një kurvë e madhe, që qëndron mbi ujëra me rrobe të kuqe, e dehur nga gjaku i shenjtorëve dhe i martirëve të Jezuit; ky është qyteti i madh mbi shtatë kodrat, që mbretëron mbi gjithë mbretërit e tokës. Ajo është hipur mbi një bishë me shtatë krerë dhe me dhjetë brirë. Të shtatë krerët përfaqësojnë të shtatë kodrat, si dhe shtatë «mbretër». Nga këta shtatë mbretër pesë kanë rënë, njëri është, ndërsa i shtati do të vijë dhe pas tij do të vijë përsëri njëri nga pesë të parët, i plagosur për vdekje, por i shëruar. Ky i fundit do të sundojë në Tokë 42 muaj, ose 3½ vjet (gjysma e javës vjetore prej 7 vjetësh), do t'i ndjekë për vdekje besimtarët dhe do të mbretërojë mohimi i zotit. Por pastaj do të fillojë beteja e fundit vendimtare; shenjtorëve dhe martirëve do t'u merret haku me shkatërrimin e kurvës së madhe Babiloni dhe të gjithë përkrahësve të saj, d.m.th. të një mase shumë të madhe njerëzish; djalli do të përmbyset në greminë dhe do të mbahet i mbyllur atje për një mijë vjet, gjatë të cilëve do të mbretërojë Krishti me martirët që do të ngjallen së vdekuri. Por pasi të kenë kaluar të një mijë vjetët, djalli do të lirohet përsëri dhe do të bëhet një betejë tjetër e madhe e frymëve, në të cilën ai do të mundet përfundimisht. Atëherë do të bëhet ngjallja e dytë e të vdekurve, kur edhe të vdekurit e tjerë do të zgjohen e do të paraqiten përpara gjyqit të zotit (vini re — të zotit, e *jo* të Krishtit!), dhe besimtarët do të hyjnë në një qiell të ri, në një Tokë të re dhe në Jerusalemin e ri për jetën e amshuar.

Të gjitha këto janë ndërtuar vetëm e vetëm me materialin e judaizmit të parakrishterë dhe prandaj japin pothuajse vetëm parafytyrime thjesht judaike. Qysh atëherë, kur për popullin e Izraelit filluan në këtë

botë kohë të vështira — që nga haraçi që u pagoi asirianëve dhe babilonasve, nga shkatërrimi i të dy mbretërive, të Izraelit dhe të Judesë, e deri te skllavërimi nga ana e Seleukidëve, pra që nga Isai deri te Danieli, — sa herë që vjen një fatkeqësi, profetizohet ardhja e një shpëtimtari. Edhe te Danieli, kap. XII, vargu 1-3 gjejmë një profeci mbi zbritjen e Mihailit, engjëllit që ruante judejtë, i cili do t'i shpëtonte ata nga fatkeqësia e madhe; shumë nga të vdekurit do të ngjallen, do të bëhet njëfarë gjyq i tmerrshëm dhe mësuesit që i kanë treguar popullit rrugën e drejtë do të shkëlqejnë përjetë si yje. Karakter të krishterë ka vetëm theksimi i ardhjes së shpejtë të mbretërisë së Krishtit dhe të lavdisë së besimtarëve të ngjallur së vdekuri, kryesisht të martirëve.

Shpjegimin e kësaj profecie, përderisa ajo ka të bëjë me ngjarjet e asaj kohe, ne ia detyrojmë kritikës gjermane, sidomos Evaldit, Lykes dhe Ferdinand Benarit. Në saje të Renanit ky shpjegim u bë i kuptueshëm edhe për qarqet joteologjike. Që kurva e madhe Babiloni përfaqëson Romën, — qytetin mbi shtatë kodra, — këtë e kemi parë. Për bishën, mbi të cilën është ulur ajo, në kap. XVII, vargu 9-11, thuhet kështu:

> «të shtatë krerët» (e bishës) «janë shtatë kodra, ku rri gruaja mbi ata. Edhe janë shtatë mbretër; të pesëtë ranë, edhe njëri është, edhe tjetëri edhe s'ka ardhurë; edhe kur të vinjë, pak kohë duhetë të mbetetë. Edhe bisha që ishte, edhe nuk është, edhe ky është i tetti mbret, edhe është nga të shtatëtë dhe do të vdesë».

Këtu bisha simbolizon sundimin botëror romak, që përfaqësohet me radhë nga shtatë perandorë, njëri prej të cilëve u plagos për vdekje dhe nuk sundon më, por është shëruar e do të kthehet për të ngritur, si pe-

randor i tetë, mbretërinë e vllasfimisë dhe të rebelimit kundër zotit. Edhe iu dha asaj

> «të bënjë luftë me shënjtorët, edhe t'i muntnjë; edhe dot'i falen' asaj gjith ata që rrinë mbi dhet, emërat e të cilëvet nuk janë shkruarë ndë vivlit të jetës'së qëngjit; edhe bënte të gjithë, të vegjëlit'e të mëdhenjtë, edhe të pasurit' edhe të vobeqtë, edhe të lirët' edhe shërbëtorët, të marrënë një shënjë të gërvishturë mbë dorën e tyre të djathtë, a mbë ballërat'e tyre; edhe që të mos muntte ndonjë të blerë a të shesë, përveç ay që ka të gërvishturitë, a emrin e bishësë, a numërin' e emërit të asaj. Këtu është dituria; ay që ka mëndjenë ndë kokë le të bënjë llogari numërin'e bishës, sepse është numër njeriu, edhe numër' i asaj është gjashtë qint e gjashtdhjet'e gjashtë» (kap. XIII. vargu 7-18).

Pra, ne vetëm konstatojmë se këtu përmendet bojkotimi si një nga mjetet që u përdorën kundër të krishterëve nga ana e fuqisë botërore romake, pra, është e qartë se kjo qenkej një shpikje e djallit, dhe kalojmë në çështjen se kush është ky perandor romak që paskej sunduar njëherë, qenkej plagosur për vdekje dhe u zhduk, por që do të kthehet si perandor i tetë dhe do të luajë rolin e antikrishtit.

Po të marrim Augustin si të parin, i dyti do të jetë Tiberi, i treti Kaligula, i katërti — Klaudi, i pesti — Neroni, i gjashti — Galba. «Pesë ranë, edhe njëri është». Domethënë Neroni ka rënë, ndërsa Galba është. Galba sundoi prej 9 qershorit të vitit 68 deri më 15 janar të vitit 69. Por me të hipur ai në fron, legjionet e Rinit ngritën krye nën udhëheqjen e Vitelit, ndërsa në provincat e tjera po përgatiteshin kryengritje ushtarake nga gjeneralë të tjerë. Brenda në Romë u ngritën pretorianët, vranë Galbën dhe shpallën perandor Otonin.

Nga kjo mund të nxjerrim si përfundim se Zbulesa jonë u shkrua në kohën e Galbës, ndoshta, nga fundi i sundimit të tij ose, e shumta, në kohën e sundimit prej tre muajsh (deri më 15 prill të vitit 69) të Otonit, që ishte «i shtati». Po kush është i teti, që ka qenë e që nuk është më? Këtë do të na e tregojë numri 666.

Ndër semitët — kaldejtë dhe judejtë — atëherë ishte përhapur një art magjik që bazohej në kuptimin e dyfishtë të germave. Afërsisht 300 vjet para erës sonë germat hebraike përdoreshin edhe si numra: a = 1; b = 2; g= 3; d = 4 etj. Fallxhorët kabalistë llogaritnin shumën e vlerës numerike të germave të ndonjë emri dhe në bazë të kësaj shume mundoheshin të bënin profecira; për shembull, duke formuar fjalë ose bashkime fjalësh që kishin të njëjtën vlerë numerike, i tregonin të ardhmen atij që kishte këtë emër. Po në këtë gjuhë shifrash shpreheshin edhe fjalët e fshehta etj. Ky art quhej me fjalën greke *gematriah*, gjeometri; kaldejtë, që merreshin shumë me të dhe që Taciti i pat quajtur *mathematici*, në kohën e Klaudit, dhe më vonë përsëri në kohën e Vitelit, u dëbuan nga Roma, siç duket, për «shkelje trashanike të rendit».

Edhe numri 666 lindi po nga kjo matematikë. Prapa tij fshihet emri i njërit nga të pesë perandorët e parë romakë. Por Irineu në fund të shekullit të dytë, përveç numrit 666, dinte edhe variantin 616, i cili doli në atë kohë kur, sidoqoftë, shumë njerëz e dinin ende të fshehtën e këtij numri. Në qoftë se zgjidhja e kërkuar u shkon të dy këtyre numrave, në këtë mënyrë do të dalë e provuar edhe saktësia e saj.

Këtë zgjidhje e dha Ferdinand Benari në Berlin. נרון קסר Emri është Neron. Ky numër bazohet në (Neron Kesar), d.m.th. në shkrimin hebraik, të vërtetuar nga talmudi dhe nga mbishkrimet e Palmirit, të fjalëve greke Nerôn Kaisar, perandori Neron, — fjalë që ishin shkruar mbi monedhat që nxori Neroni

në gjysmën lindore të perandorisë. Po e shpjegojmë: n *(nun)* = 50; r *(resh)* = 200; v *(vov)* në vend të 0 = 6; n *(nun)* = 50; k *(kuf)* = 100; s *(sameh)* = 60; dhe r *(resh)* = 200; përfundimi = 666. Po të marrim për bazë shkrimin latin Nero Caesar, atëherë nun = 50, që është germa e dytë, hiqet dhe do të kemi 666 — 50 = 616, d.m.th. variantin e Irineut.

Me të vërtetë, në kohën e Galbës në gjithë Perandorinë Romake u përhap një trazirë e papritur. Vetë Galba ishte në krye të legjioneve spanjolle dhe gale, që marshuan drejt Romës për të përmbysur Neronin; ky i fundit iku dhe i dha urdhër një skllavi të liruar që ta vriste. Por kundër Galbës kishin bërë komplot jo vetëm pretorianët në Romë, por edhe komandantët në provinca; kudo dilnin pretendues të rinj për fronin, që përgatiteshin të marshonin me legjionet e tyre drejt kryeqytetit. Dukej sikur tërë perandorinë e kishte pushtuar lufta e brendshme dhe po afrohej shembja e saj. Për më tepër, pikërisht në Lindje u hap fjala se Neroni nuk ishte vrarë, por vetëm sa ishte plagosur, ishte strehuar te partianët dhe do të kthehej me ushtri që përtej Eufratit për të filluar një sundim të ri, edhe më të përgjakshëm e të tmerrshëm. Këto lajme tmerruan sidomos Akainë dhe Azinë. Dhe pikërisht rreth asaj kohe, kur u shkrua, me sa duket, Zbulesa, doli një pseudo-Neron, i cili me një numër mjaft të madh pasuesish u vendos pranë Patmosit dhe Azisë së Vogël, në ishullin Kitnos në detin Egje (në Termian e sotme), derisa u vra qysh në kohën e Otonit. A ka ndonjë gjë për t'u habitur, në qoftë se midis të krishterëve, kundër të cilëve Neroni kishte drejtuar ndjekjet e para serioze, u përhap ideja se ai do të kthehej përsëri si antikrisht dhe se kthimi i tij, bashkë me orvatjen e pashmangshme për një shfarosje të përgjakshme të sektit të ri, janë paralajmërimi dhe prologu i ardhjes së dytë të Krishtit, i betejës së madhe ngadhënjimtare kundër forcave të ferrit, i vendosjes «së

shpejtë» të mbretërisë mijëvjeçare, bindja për ardhjen e së cilës i bënte martirët të pranonin vdekjen me gëzim?

Letërsia e krishterë dhe letërsia e dy shekujve të parë, që është nën ndikimin e krishterimit, na jep mjaft të dhëna që dëshmojnë se e fshehta e numrit 666 atëherë njihej nga shumë njerëz. Ç'është e vërteta, Irineu nuk e dinte më këtë të fshehtë, por ai, si edhe shumë njerëz të tjerë që kanë jetuar deri në fund të shekullit të tretë, e dinte se me bishën apokaliptike nënkuptohej Neroni që kthehet përsëri në fron. Pastaj humb edhe kjo gjurmë dhe vepra jonë interpretohet në mënyrë fantastike nga profetët ortodoksë të së ardhmes; kur isha fëmijë, edhe unë vetë kam njohur disa pleq, të cilët pas plakut Joan Albreht Bengelit prisnin mbarimin e botës dhe gjyqin e tmerrshëm në vitin 1836. Kjo profeci u vërtetua, dhe pikërisht atë vit. Veçse gjyqi i tmerrshëm nuk u bë kundër botës mëkatare, por kundër vetë interpretuesve të përshpirtshëm të Zbulesës. Sepse në vitin 1836 F. Benari gjeti çelësin për interpretimin e numrit 666 dhe kështu u dha fund në mënyrë të tmerrshme gjithfarë llogaritjeve profetike, gjithë kësaj *gematriah* të re.

Sa për mbretërinë e qiejve, e cila i pret besimtarët, Joani ynë mund të japë vetëm një përshkrim shumë të përciptë. Jerusalemi i ri, natyrisht, është mjaft i madh, të paktën për atë kohë; ai shtrihet në një sipërfaqe katrore, çdo anë e së cilës është 12 mijë stade = 2 227 km, pra, sipërfaqja e tij është gati 5 milionë km. katrore, më shumë se gjysma e Shteteve të Bashkuara të Amerikës; ai është ndërtuar me ar të kulluar dhe gurë të çmuar. Atje jeton zoti midis besnikëve të tij, ai u bën dritë në vend të Diellit, dhe atje nuk ka më as vdekje as trishtim as vuajtje; një rrymë uji gjallërues kalon nëpër qytet dhe në brigjet e tij rriten drurët e jetës me 12 lloje frutash që piqen përsëri çdo muaj, ndërsa gjethet i «shërbejnë shëndetit të po-

pujve». Sipas mendimit të Renanit, ky është një lloj çaji mjekësor (shih «Antikrishti», f. 542). Shenjtorët atje jetojnë në amshim.

Me sa e njohim ne, i tillë ishte krishterimi që u krijua në Azinë e Vogël, në selinë e tij kryesore rreth vitit 68. Asnjë gjurmë të trinisë së shenjtë — përkundrazi, Jehova i vjetër, i vetëm e i pandarë i judaizmit të vonshëm, i cili nga një perëndi kombëtare e judejve u bë sundimtar i vetëm i qiellit dhe i Tokës, që kërkon të vendosë sundimin e vet mbi të gjithë popujt, u premton mëshirë atyre që kthehen në fenë e tij dhe dërrmon pa mëshirë ata që nuk shtrohen, ai është besnik ndaj porosisë antike: *parcere subjectis ac debellare superbos**. Prandaj gjyqin e tmerrshëm e kryeson vetë kjo perëndi, e jo Krishti, siç duan të thonë ungjijtë dhe kartat e mëvonshme! Sipas doktrinës persiane të emanacionit, që u përvetësua nga judaizmi i vonshëm, Krishti-qengj në fillim ka rrjedhur nga zoti, po prej tij rrjedhin — por qëndrojnë një shkallë më poshtë — edhe «shtatë frymët e zotit», të cilat ekzistencën e tyre ia detyrojnë një interpretimi të gabuar të një figure poetike të Isaisë (kap. XI, vargu 2). Të gjithë ata nuk janë zoti ose të barabartë me zotin, por të nënshtruar ndaj tij. Qengji bëhet fli vetë për të larë mëkatet e botës dhe për këtë në qiell ngrihet në një gradë më të lartë; sepse kjo vdekje e tij vullnetare si flijim i njihet në të gjithë librin si një meritë e jashtëzakonshme, e jo si diçka që rrjedh medoemos nga vetë esenca e tij e brendshme. Kuptohet vetiu se ekziston edhe një personel i tërë oborrtarësh qiellorë: kryeengjëj, kerubinë, engjëj dhe shenjtorë. Për t'u bërë fe, monoteizmit që prej kohëve më të lashta iu desh t'i bënte lëshime politeizmit, duke filluar që nga Zendavesta[132]. Te judejtë vazhdoi në mënyrë kronike ka-

* — të mëshirohen të përulurit dhe të luftohen kryelartët. *Red.*

limi nga judaizmi te perënditë materiale pagane, dhe, pas dëbimit, krijimi i një personeli oborrtarësh qiellorë, sipas modelit persian, ia përshtati diçka më mirë fenë fantazisë së popullit. Bile edhe krishterimi, i cili perëndinë gjithmonë të njëjtë dhe të palëvizshme të judejve e zëvendësoi me një trini në vetvete të diferencuar dhe misterioze, mundi ta zhdukte kultin e perëndive të vjetra në masat e popullit vetëm duke vënë kultin e shenjtorëve; kështu, sipas fjalëve të Falmerajerit, kulti i Jupiterit u zhduk në Peloponez, në Majnë dhe në Arkadi vetëm rreth shekullit IX («Historia e gadishullit të Moresë», vëll. I, f. 227[133]). Vetëm periudha borgjeze e sotme me protestantizmin e saj po i mënjanon përsëri shenjtorët dhe po e merr, më në fund, seriozisht monoteizmin e diferencuar.

Po aq pak e njohur është për shkrimin që bëjmë fjalë edhe doktrina mbi mëkatin e parë dhe mbi pastrimin me anë të besimit. Besimi i këtyre komuniteteve të para luftarake nuk i ngjan fare besimit të kishës së mëvonshme ngadhënjimtare. Krahas flijimit të qengjit, për larjen e mëkateve, përmbajtja e tij më e rëndësishme është ardhja e dytë e shpejtë e Krishtit dhe mbretëria e afërt mijëvjeçare, dhe ky besim sprovohet vetëm me propagandë aktive, me luftë të palodhur kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, me pohimin krenar të bindjeve të veta revolucionare përpara gjykatësve paganë, me gatishmërinë për të pranuar vdekjen prej martiri për hir të fitores së ardhshme.

Pamë se autori ynë as që e di akoma se ai është diçka tjetër, e jo jude. Në lidhje me këtë në të gjithë librin nuk gjen asgjëkundi as edhe një fjalë për pagëzimin, bile edhe shumë gjëra të tjera na bindin se pagëzimi është një institucion që i përket periudhës së dytë të krishterimit. 144 mijë besimtarë judej u «damkosën» e nuk u pagëzuan. Për shenjtorët në qiell dhe besimtarët në Tokë thuhet se ata i shlyen mëkatet dhe rrobat e tyre të bardha i lanë me gjakun e qengjit dhe

i bënë të çelëta; për pagëzimin e shenjtë as që bëhet fjalë. As dy profetët që erdhën para daljes së antikrishtit (kap. XI) gjithashtu nuk pagëzojnë njeri, dhe, sipas kap. XIX, vargu 10, simboli i Jezuit nuk është pagëzimi, por fryma e profecisë. Në të gjitha këto raste do të ishte e natyrshme të përmendej pagëzimi, po qe se përdorej ai qysh atëherë; prandaj ne mund të nxjerrim me siguri pothuajse të plotë konkluzionin se autori ynë nuk e njihte pagëzimin, se ai lindi vetëm atëherë kur të krishterët u ndanë përfundimisht nga judejtë.

Po aq pak di autori edhe për sakramendin e dytë të mëvonshëm — për kungimin. Në qoftë se në tekstin luteran Krishti i premton çdo tiatirasi që ka besim të fortë se do të shkojë te ai dhe do të hajë me të darkën e fundit, kjo vetëm sa të ngatërron. Në tekstin grek thuhet: «*deipnêsô* — unë do të ha darkën (me të), dhe bibla angleze e jep shumë sakt këtë me fjalët: «*I shall sup with him*». Për vetë darkën e fundit qoftë edhe si një gosti e thjeshtë përkujtimore këtu as që bëhet fjalë fare.

Që libri ynë me datën e tij të përcaktuar në mënyrë kaq origjinale — viti 68 ose 69 — është më i vjetri nga gjithë letërsia e krishterë, për këtë nuk mund të ketë dyshim. Nuk ka asnjë libër tjetër që të jetë shkruar me një gjuhë kaq barbare, plot hebraizma[134], konstrukte të pakuptueshme dhe gabime gramatikore. Kështu, në kap. I, vargu 4, është thënë fjalë për fjalë kështu: «Hir dhe paqtim qoftë mbë ju nga ay që është edhe që ishte edhe që vjen». Që ungjijtë dhe Punët e apostujve janë përpunime të mëvonshme shkrimesh që tani kanë humbur, thelbi historik i dobët i të cilave tani nuk mund të dallohet nën cipën e legjendës; që bile edhe dy të ashtuquajturat karta «autentike» (sipas Bruno Bauerit) të apostujve janë ose shkrime të mëvonshme ose, në rastin më të mirë, përpunime veprash të vjetra autorësh të panjohur me ndryshime, shtesa dhe plotësime, — këtë sot mund ta mohojnë vetëm teologët profesionistë ose historianë të tjerë të interesuar. Aq më tepër rëndësi ka fakti se këtu kemi të bëjmë me një libër, koha e shkrimit të të cilit është përcaktuar me përpikmëri deri në disa muaj, — një libër që na e tregon krishterimin në formën e tij më të pazhvilluar, formë në të cilën ai është po në atë raport me fenë zyrtare të shekullit IV, me dogmat dhe me mitologjinë e saj plotësisht të përpunuara, në të cilin është mitologjia akoma e paqëndrueshme e gjermanëve të kohës së Tacitit me doktrinën e perëndive të Edës, që u formua nën ndikimin e elementëve të krishterë dhe antikë. Natyrisht, embrioni i fesë botërore është, por ky embrion përmban akoma në të njëjtën shkallë të gjitha ato mijëra mundësi zhvillimi, të cilat u realizuan pastaj në sektet e panumërta të mëvonshme. Dhe ky monument më i lashtë i procesit të formimit të krishterimit ka rëndësi të veçantë për ne, pikërisht sepse ai na jep në trajtë të kulluar atë që judaizmi — nën ndikimin e fuqishëm aleksandrin — pruri në krishterimin. Të gjitha ato që u shtuan më vonë janë shtesë perëndimore, greko-romake. Vetëm nëpërmjet fesë monoteiste të judejve monoteizmi i stërholluar i filozofisë së mëvonshme vulgare greke mundi të merrte atë formë fetare, që është e vetmja me të cilin ai mund t'i bënte për vete masat. Por me t'u bërë kjo ndërmjetësi, ai mund të bëhej fe botërore vetëm në botën greko-romake, duke zhvilluar më tej rrethin e ideve të përpunuar nga kjo botë dhe duke u shkrirë me të.

SHËNIME

1 Marksi ka parasysh librin: «Petri Gassendi Animadversiones in decimum librum Diogenis Laertii, qui est de Vita, Moribus, Placitisque Epicuri» («Vërejtje të Pier Gasendit mbi librin e dhjetë të Diogjen Laercit, që flet për jetën, zakonet dhe mendimet e Epikurit»), që doli në Lion në vitin 1649. — *9.*

2 Janë ruajtur disa materiale të Marksit mbi historinë e filozofisë epikuriane, stoike dhe skeptike në shtatë fletore të shkruara prej tij më 1839, të cilat ai i shfrytëzoi pastaj pjesërisht në disertacionin e vet. — *10.*

3 Është fjala për librin: K. F. Köppen «Friedrich der Grosse und seine Widersacher», Leipzig, 1840. — *10.*

4 Marksi citon nga libri i D. Hjumit «Mbi natyrën njerëzore» nga botimi gjermanisht i librit « Ueber die menschliche Natur». Erster Band. Halle, 1790, S. 485. — *11.*

5 Marksi citon një fragment nga letra e Epikurit, drejtuar Menojkeut sipas librit të dhjetë të Diogjen Laercit; këtë citat Marksi e ka dhënë në gjuhën greqishte. — *11.*

6 Këto vargje, si dhe vargun e mësipërm nga tragjedia e Eskilit «Prometeu i lidhur», Marksi i ka dhënë në gjuhën greqishte. — *12.*

7 *«Kölnische Zeitung»* («Gazeta e Këlnit») — gazetë e përditshme gjermane, që dilte me këtë emër në Këln nga viti 1802. Në vjetët 30, si dhe në fillim të vjetëve 40 të shekullit XIX mbronte kishën katolike kundër protestantizmit që sundonte në shtetin prusian. «Kölnische Zeitung», redaktor politik i së cilës në vitin 1842 u bë publicisti reaksionar Hermes — agjent i fshehtë i qeverisë prusiane — zhvillonte një luftë të tërbuar kundër «Rheinische Zeitung», që redaktohej nga Marksi. — *13.*

8 Marksi citon nga botimi gjermanisht i Lukianit: «Griechische Prosaiker in neuen Übersetzungen». Fünftes Bändchen. Stuttgart, 1827, S. 176 («Prozatorët grekë në përkthime të reja». Libri i pestë. Shtutgart, 1827, f. 176). — *14.*

9 *Fetishizëm* — hyjnizim i sendeve dhe i objekteve të ndryshme, të cilave u vishet një forcë misterioze, e mbinatyrshme; mbeturina të fetishizmit ka edhe në fetë e sotme. — *21.*

10 *Filozofia e Epikurit* — një nga sistemet më të përpunuara të materializmit të Greqisë së Vjetër; dallohej për karakterin e vet iluminist dhe ateist. Epikuri mohonte ndërhyrjen e perëndive në punët e botës dhe mbronte tezën se materia ka karakter të përjetshëm dhe është e pajisur me një burim të brendshëm lëvizjeje. Ai hidhte poshtë pikëpamjen se shpirti është i pavdekshëm dhe luftonte kundër injorancës dhe bestytnive, që lindin frikën përpara perëndive dhe vdekjes. Si qëllim të filozofisë ai shpallte lumtërinë e njeriut; për këtë duhet të çlirohesh nga paragjykimet dhe të njohësh ligjet e natyrës. Teoria materialiste e Epikurit shtrembërohej me të gjitha mënyrat nga historianët idealistë të filozofisë dhe ishte objekt i një urrejtjeje të veçantë dhe ndjekjesh nga ana e kishës. — *22.*

11 *Stoikët* — përfaqësuesit e rrymës filozofike, që lindi në Greqinë e Vjetër në shekullin III para erës sonë dhe vazhdoi deri në shekullin VI të erës sonë, rrymë që lëkundej midis materializmit dhe idealizmit. Në periudhën e parë (stoa e

vjetër dhe e mesme) ata u morën kryesisht me studimin e ligjeve të natyrës dhe me teorinë e njohjes, dhe këtë e bënin duke u nisur kryesisht nga pozitat materialiste. Në kohën e Perandorisë Romake (stoa e re) tregonin një interesim të veçantë për problemet morale. Këto probleme ata i trajtonin në frymën idealiste fetare, duke mbrojtur pikëpamjen se shpirti ekziston jashtë trupit, duke mbrojtur kultin e nënshtrimit të njeriut ndaj fatit, moskundërshtimin ndaj së keqes, vetëmohimin dhe asketizmin, kërkimin e zotit etj.; të gjitha këto ndikuan në formimin e fesë së krishterë. — *22.*

12 *Skeptikët* — përfaqësuesit e një rryme filozofike të periudhës së shpërbërjes së shoqërisë skllavopronare në Greqi dhe në Romë, e cila vinte në dyshim mundësinë e njohjes së saktë të së vërtetës objektive dhe, si pasojë, edhe mundësinë e zhvillimit të mendimit shkencor. Në doktrinën e skeptikëve të lashtë, që shprehnin tendencën idealiste subjektive, u pasqyrua degjenerimi i mendimit filozofik antik, i cili dikur pat qenë i fuqishëm. — *22.*

13 *Vedat* — Veprat më të lashta të letërsisë dhe të fesë indiane në vjershë dhe në prozë; ato janë hartuar gjatë shekujve, por jo më vonë se shekulli VI p.e.r. — *24.*

14 Shih «Mbreti Lir» të U. Shekspirit, Skena II, bot. shqip, 1960, f. 57. — *30.*

15 *«Rheinische Zeitung für Politik, Handel und Gewerbe»* («Gazeta e Rinit për çështjet e politikës, të tregtisë dhe të industrisë») — gazetë e përditshme që dilte në Këln nga 1 janari 1842 deri më 31 mars 1843. Kjo gazetë u themelua nga disa përfaqësues të borgjezisë renane, e cila mbante një qëndrim opozitar ndaj absolutizmit prusian. Në këtë gazetë bashkëpunuan edhe disa hegelianë të rinj (hegelianë të majtë). Nga prilli i vitit 1842 K. Marksi u bë bashkë-

punëtor i «Rheinische Zeitung», dhe nga tetori i po atij viti u bë një nga redaktorët e saj. Në «Rheinische Zeitung» u botuan edhe një sërë artikujsh të F. Engelsit. Gjatë kohës që Marksi ishte redaktor kjo gazetë filloi të merrte një karakter demokratik revolucionar gjithnjë më të përcaktuar. Qeveria vuri një censurë të rreptë për «Rheinische Zeitung» dhe më vonë e mbylli atë. — *30.*

16 Është fjala për pjesëmarrjen e redaktorit të «Kölnische Zeitung», Hermesit, kur ishte i ri, në lëvizjen opozitare të studentëve gjermanë. — *30.*

17 *Koribantët* — priftërinjtë e kultit të perëndeshës Kibela; *kabirët* — priftërinjtë e kultit të perëndive të grekëve të vjetër — kabirëve. Në Azinë e Vogël koribantët dhe kabirët identifikoheshin me kuretët e Kretës — priftërinjtë e nënës së Zeusit, perëndeshës Rea. Sipas mitologjisë, kuretët, duke u rënë mburojave me shpata, mbulonin britmat e Zeusit të porsalindur. — *32.*

18 Marksi ka parasysh polemikën e ashpër të shtypit reaksionar gjerman kundër kritikës filozofike të fesë; këtë kritikë e filloi Shtrausi me librin «Jeta e Jezuit» (D. F. Strauss. «Das Leben Jesu»), vëllimi i parë i kësaj kritike doli në dritë më 1835, i dyti — më 1836. — *32.*

19 *«Berliner politisches Wochenblatt»* («E Përjavshmja politike e Berlinit») — organ ultrareaksionar, botohej prej vitit 1831 deri në vitin 1841 me pjesëmarrjen e K. Galerit, Leos, Raumerit etj.; ndihmohej dhe përkrahej nga princi trashëgimtar Frederik Vilhelmi (prej vitit 1840 — mbreti Frederik Vilhelm IV). — *33.*

20 *«Hamburger Korrespondent»* — emër i shkurtuar i gazetës «Staats und Gelehrte Zeitung des Hamburgischen unparteiischen Korrespondenten» («Gazeta politike dhe shkencore e korrespondentit të paanshëm të Hamburgut»).

Në vjetët 1840-1850 kjo gazetë dilte çdo ditë dhe kishte një drejtim monarkist reaksionar. — *33.*

21 *«Deutsche Jahrbücher»* — emër i shkurtuar i revistës filozofike-letrare të hegelianëve të rinj «Deutsche Jahrbücher für Wissenschaft und Kunst» («Vjetari gjerman i shkencës dhe i artit»). Kjo revistë botohej në Lajpcig nën redaktimin e A. Ruges prej korrikut të vitit 1841 deri në janar të vitit 1843. — *33.*

22 Marksi, siç duket, ka parasysh vendosjen e monopolit të kishës katolike në fushën e kulturës dhe të ideologjisë në periudhën e mesjetës së hershme, kur, siç thoshte Engelsi, u fshi nga faqja e dheut qytetërimi i lashtë, filozofia e lashtë, politika dhe jurisprudenca. «Si rezultat i kësaj, siç ndodh në të gjitha fazat e hershme të zhvillimit, monopoli i kulturës intelektuale ra në duart e priftërinjve dhe vetë kultura mori kështu një karakter kryesisht teologjik» (F. Engels. «Lufta fshatare në Gjermani», bot. shqip, 1975, f. 28). Në duart e klerit politika dhe jurisprudenca u shndërruan në degë të thjeshta të teologjisë. Bashkë me filozofinë antike ranë edhe shkencat e natyrës dhe matematika, që lidheshin me të. Poezia, muzika dhe artet figurative u vunë gjithashtu në shërbim të kishës. Letërsia u katandis në një përshkrim të jetës së «shenjtorëve», ndërsa historia në një kronikë kishëtare. Filozofia u bë shërbëtore e teologjisë, në të gjitha fushat e diturisë njerëzore kisha mbronte pikëpamjet antishkencore dhe ato më reaksionaret. — *34.*

23 *Nata e shën Bartolomeut* — masakër në masë kundër protestantëve hugenotë, e bërë nga katolikët në Paris natën e 24 gushtit 1572 (duke gdhirë dita e shën Bartolomeut) me urdhër të oborrit të Francës dhe me nxitjen e klerit katolik. Kjo masakër vazhdoi tri ditë, gjatë të cilave u vranë disa mijëra vetë. Masakra të tilla kundër hugenotëve u organizuan në të gjithë Francën. — *34.*

24 *Inkuizicioni* — institucion hetues dhe gjyqësor i kishës katolike, i krijuar nga papati në shekullin XIII për të zhdukur heretikët dhe ata që dyshoheshin për herezi. Gjatë mesjetës inkuizicioni shërbente si armë në luftën kundër lëvizjeve antifeudale dhe antikatolike, kundër çdo shfaqjeje të mendimit të lirë; shumë shkencëtarë të mëdhenj të mesjetës ranë viktima të inkuizicionit. Ai vepronte me anë të spiunazhit, të korruptimit të dëshmitarëve, të torturave shtazarake dhe të gjyqit kishtar me dyer të mbyllura; dënimet e tij dalloheshin për një ashpërsi të jashtëzakonshme. Mbi zjarret dhe në burgjet e inkuizicionit vdiqën qindra mijëra njerëz të pafajshëm. Nga mesi i shekullit XIX inkuizicioni humbi një pjesë të madhe të funksioneve të veta, por ai edhe më vonë vazhdoi t'i ndiqte pikëpamjet përparimtare dhe revolucionare. — *34.*

25 *Hugenotët* — protestantë-kalvinistë në Francën e shekujve XVI-XVII. Masën kryesore të lëvizjes hugenote në periudhën e parë e përbënin borgjezia dhe zejtarët. Më vonë rolin kryesor në të filluan ta luanin fisnikëria provinciale e Francës Jugore dhe një pjesë e parisë feudale, që ishin të pakënaqura nga politika centralizuese e pushtetit mbretëror. Zhvillimi i lëvizjes hugenote çoi në luftën civile midis katolikëve dhe hugenotëve, që filloi në vitin 1562 dhe mori një karakter veçanërisht të ashpër pas natës së shën Bartolomeut në vitin 1572, duke vazhduar me ndërprerje deri në vitin 1594. Edikti i Nantës, që u shpall në vitin 1598, u dha hugenotëve lirinë e besimit. Por deri në revolucionin francez të fundit të shekullit XVIII qeveria dhe kisha katolike vazhduan t'i ndiqnin hugenotët. — *37.*

26 *«Königsberger Zeitung»* — emër i shkurtuar i gazetës së përditshme «Königlich-Preussische Staats-Kriegs- und Friedens-Zeitung» («Gazeta mbretërore prusiane për çështjet e shtetit, të luftës e të paqes»); me këtë emër ajo dilte në Kënigsberg prej vitit 1752 deri në vitin 1850. Në vjetët 1840-1850 ajo ishte një gazetë borgjeze përparimtare. — *40.*

27 Është fjala për shkollën historike të së drejtës — një rrymë reaksionare në shkencën historike dhe juridike, që lindi në Gjermani në fund të shekullit XVIII. — *45.*

28 Marksi ka parasysh filozofin Anaharsis, me origjinë skithe, të cilin grekët, siç dëshmon Diogjen Laerci, e përfshinin në grupin e shtatë të urtëve grekë. — *49.*

29 *Ligjet e shtatorit* — ligje reaksionare të shpallura nga qeveria franceze në shtator të vitit 1835; ato kufizonin veprimtarinë e gjyqit të jurisë dhe përmbanin masa të rrepta kundër shtypit. Për shtypin parashikoheshin tatime më të mëdha në të holla për botimet periodike, burgimi dhe gjoba të rënda për shkrimet kundër pronës dhe rendit shtetëror ekzistues. — *56.*

30 *«Familja e shenjtë, ose Kritika e kritikës kritike. Kundër Bruno Bauerit me shokë»* — vepra e parë e përbashkët e K. Marksit dhe F. Engelsit. Kjo vepër, që u shkrua në shtator-nëntor të vitit 1844, doli në dritë në shkurt të vitit 1845 në Frankfurt-mbi-Majn.

«Familja e shenjtë» është një emër ironik që u është vënë vëllezërve Bauer dhe pasuesve të tyre, që ishin bashkuar rreth «Allgemeine Literatur-Zeitung» («Gazeta letrare e përbashkët»). Marksi dhe Engelsi kritikuan pikëpamjet e tyre idealiste, shkëputjen nga jeta reale, thellimin e tyre në diskutime filozofike e teologjike abstrakte. Duke rënë në subjektivizëm, hegelianët e rinj i quajtën masat e popullit vetëm material të plogësht, ballast në procesin historik, ndërsa individët e zgjedhur, dhe në mënyrë të veçantë veten e tyre, i quajtën bartës të «frymës», të «kritikës absolute», krijues të historisë. Ndonëse hidhnin poshtë vërtetësinë e ungjijve, hegelianët e rinj e identifikonin ndërgjegjen fetare me ndërgjegjen e popullit. Pengesat kryesore në rrugën e zhvillimit progresiv të Gjermanisë për ta nuk ishin rendi shoqëror reaksionar që sundonte atje, por vetëm idetë sunduese, sidomos feja. Kështu, ata nuk ngri-

heshin kundër këtij rendi shoqëror, por vetëm kundër ideve dhe frazave sunduese. «Të vetmet rezultate që mundi të arrinte kjo kritikë filozofike ishin disa shpjegime historike fetare, edhe ato të njëanshme, rreth krishterimit» (Marks e Engels) — *62.*

31 *Metafizika* — mënyrë antidialektike e të menduarit dhe metodë njohjeje, që i shikon sendet dhe fenomenet si të mbaruara, të pandryshueshme, të shkëputura nga njëri-tjetri dhe pa kontradikta të brendshme.

Në këtë rast është fjala për metafizikën në kuptimin që i jepej asaj deri në shekullin XIX, dhe pikërisht si një pjesë e filozofisë, që trajtonte në mënyrë thjesht spekulative çështje që ishin jashtë caqeve të eksperiencës, për shembull, mbi zanafillën e qenies, mbi thelbin e botës, mbi zotin, mbi shpirtin, mbi lirinë e vullnetit etj. Me fjalët metafizikanë të shekullit XVII Marksi ka parasysh racionalistët, që e quanin arsyen si të vetmin burim të njohjes së vërtetë dhe që nuk përfillnin eksperiencën ndijore, duke e quajtur të pasaktë. Në qoftë se në shekullin XVII kjo rrymë luajti një rol përparimtar, duke mbrojtur gjithëfuqinë e arsyes në luftën kundër rrymës dogmatike fetare, në shekullin XVIII ajo u bë pengesë për zhvillimin e filozofisë materialiste dhe të shkencës. — *63.*

32 *Spekulim* — arsyetime abstrakte, të shkëputura nga eksperienca dhe nga praktika, karakteristike për idealizmin. Të menduarit spekulativ niset nga parime të përgjithshme, të përcaktuara në mënyrë thjesht spekulative, e jo të nxjerra nga praktika. — *63.*

33 *Materializmi kartezian* — doktrinë e pasuesve të filozofit francez të shekullit XVII Dekart (latinisht — Cartesius), që nxorën nga filozofia e tij konkluzione materialiste. — *64.*

34 *Jezuitët* — anëtarë të njërës nga organizatat më reaksionare dhe agresive të kishës katolike — të urdhrit të jezuitëve (të «Shoqërisë së Jezuit»), të themeluar nga I. Lojola në vitin 1534. Urdhri i jezuitëve, qëllimi kryesor i të cilit ishte forcimi i katolicizmit dhe i pushtetit të papës, udhëhiqej nga parimi «qëllimi justifikon mjetet» dhe përdorte gjerësisht mashtrimin, spiunazhin, vrasjet e fshehta, ndërhyrjen në punët e brendshme të shteteve të ndryshme. Jezuitët merrnin pjesë aktive në drejtimin e veprimtarisë së inkuizicionit, duke organizuar ndjekjen e «heretikëve», duke zhdukur mendimtarët përparimtarë dhe duke luftuar kundër të gjitha lëvizjeve çlirimtare.

Jansenistët — rrymë fetare e afërt me protestantizmin në gjirin e katolicizmit në Francë dhe në Holandë. që lindi në bazë të doktrinës së teologut holandez K. Jansen. Duke u ngritur kundër hierarkisë së kishës katolike, kundër jetës shekullare të klerit të saj, duke bërë thirrje për një jetë të rreptë, të përshpirtshme, jansenistët njëkohësisht kritikuan ashpër jezuitët dhe moralin e tyre hipokrit. Në luftën që shpërtheu në gjysmën e dytë të shekullit XVII midis jezuitëve dhe jansenistëve papa i Romës dhe pushteti mbretëror në Francë morën anën e jezuitëve, duke ndjekur në mënyrë të tërbuar jansenistët. — *65.*

35 J. Locke. «An Essay Concerning Human Understanding» (Xh. Lok. «Studim mbi arsyen njerëzore»). Botimi i parë doli në Londër më 1690. — *67.*

36 *Skolastika* — emër i përbashkët i rrymave sunduese të filozofisë idealiste fetare të mesjetës, që mësohej në shkolla dhe në universitete. Duke qenë në shërbim të teologjisë, ajo nuk studionte natyrën dhe realitetin që na rrethon, por mbështetej në dogmat e kishës së krishterë, mundohej të nxirrte në mënyrë spekulative nga parimet e saj të përgjithshme konkluzione konkrete dhe të përcaktonte sjelljen e njeriut. Qysh në doktrinën e Duns Skotit, që ishte një përfaqësues i madh i filozofisë skolastike, përmbahen të gjitha elementet themelore të shpërbërjes së saj. Duns

Skoti doli si përkrahës i nominalizmit, i cili, siç ka thënë Marksi, ishte shprehja e parë e materializmit. — *67.*

37 *Nominalizmi* — rrymë në filozofinë mesjetare, e cila i quante konceptet e përgjithshme të gjinisë si emra, — si fryt i mendimit dhe i gjuhës njerëzore, — që vlejnë vetëm për të përcaktuar sendet e veçanta që ekzistojnë realisht. Në kundërshtim me realistët mesjetarë, nominalistët mohonin ekzistencën e koncepteve si prototipe dhe burime krijuese të sendeve. Pra, ata pranonin se materia është primare dhe koncepti — sekondar. Në këtë kuptim nominalizmi është shprehja e parë e materializmit në kohën e mesjetës. — *67.*

38 *Teiste* — që janë karakteristike për teizmin, për dogmën fetare që njeh ekzistencën e një zoti të vetëm personal, krijues të gjithësisë; teizmi është i papajtueshëm me botëkuptimin shkencor. — *69.*

39 *Deizmi* — rrymë filozofiko-teologjike që mohon idenë e një zoti personal, por pranon ekzistencën e zotit si shkak të parë pavetor të krijimit të botës. Në kushtet e sundimit të botëkuptimit kishtar feudal deizmi shfaqej shpesh si formë e mbuluar e materializmit dhe e ateizmit. Më vonë nën maskën e deizmit fshihej dëshira e ideologëve borgjezë për ta ruajtur dhe për ta justifikuar fenë, duke flakur vetëm dogmat dhe ritet kishtare më absurde dhe më të kompromet uara. — *69.*

40 L. Feuerbach. «Das Wesen des Christenthums». Leipzig, 1841 (L. Fojerbah. «Thelbi i krishterimit». Lajpcig, 1841). — *73.*

41 *Socializmi feudal* — rrymë reaksionare, e cila me ndihmën e demagogjisë sociale antikapitaliste donte t'i tërhiqte punëtorët në anën e klasave feudale dhe t'i shfrytëzonte në luftën kundër borgjezisë. Me një propagandë të tillë në

Francë merrej një pjesë e monarkistëve, përkrahës të dinastisë së Burbonëve, në Angli — «Anglia e Re», një grup personalitetesh politike, i përbërë prej aristokratësh dhe letrarësh që bënin pjesë në partinë tori (Dizraeli, Karlejli etj.). Kjo rrymë ushtroi njëfarë ndikimi mbi një pjesë të partisë së junkerëve feudalë prusianë; pikëpamjet e kësaj rryme propagandoheshin në gazetën «Rheinischer Beobachter», kundër së cilës drejtohet artikulli i Marksit «Komunizmi i gazetës «Rheinischer Beobachter»» (shih këtë përmbledhje, f. 87-93). — *95.*

42 *Socializmi i krishterë* — rrymë reaksionare, që mundohej të mbulonte botëkuptimin fetar me frazeologji «socialiste»; shfrytëzohej si nga klasat feudale, ashtu dhe nga borgjezia. Si rrymë deri diku e formuar ai u shfaq në Francë në vjetët 1840-1850; përfaqësuesit e tij kryesorë ishin Byshe dhe Lamene. Kjo rrymë ushtroi njëfarë ndikimi edhe në Angli, ku idetë e saj propagandoheshin nga socialistët feudalë të «Anglisë së Re», si edhe nga Ladlou, Kingsli e të tjerë. Në Gjermaninë e vjetëve 1840-1850 veçanërisht të zellshëm në propagandën e socializmit të krishterë u treguan përfaqësuesit e partisë klerikale feudale qeveritare prusiane, si edhe kisha katolike. — *96.*

43 *Besniku Ekart* — një nga heronjtë e legjendave mesjetare gjermane, figurë e njeriut besnik. — *98.*

44 Nga vjersha e Shilerit «Kënga e këmbanës». — *98.*

45 Është fjala për veprat e Daumerit: «Der Feuer- und Molochdienst der alten Hebräer». Braunschweig, 1842 («Adhurimi i zjarrit dhe i Mollohut nga hebrejtë e lashtë». Braunshvajg, 1842) dhe «Die Geheimnisse des christlichen Alterthums». Hamburg 1847 («Misteret e lashtësisë së krishterë». Hamburg, 1847), në të cilat Daumeri, në kundërshtim me pikëpamjen e përhapur që thoshte se kulti i flijimit hebrenjtë e kanë marrë nga të tjerët, mundohet të provojë

tezën antishkencore se ai ka lindur mbi bazën e fesë hebraike dhe të krishterë. — *100.*

46 *Suret e kuranit të ri* — aluzion ironik për librin e Daumerit «Mahomed und sein Werk». Hamburg, 1848 («Muhameti dhe vepra e tij». Hamburg, 1848); sure quhen arabisht kapitujt e kuranit. — *100.*

47 Është fjala për veprën e A. Kniges: «Ueber den Umgang mit Menschen». Hannover, 1804 («Mbi sjelljet me njerëzit». Hanover, 1804), në të cilën ai përcakton rregullat e sjelljes së njeriut në marrëdhëniet me të tjerët. Ky libër është mbushur me arsyetime të cekëta dhe të vërteta elementare, shumë nga të cilat përshkohen nga një egoizëm i ulët dhe nga një përulje prej skllavi përpara atyre që janë në fuqi. — *102.*

48 Marksi dhe Engelsi përmendin veprën e Johan Volfgang Gëtes «Vjetët e studimit të Vilhelm Majsterit», në të cilën ka disa skena që tregojnë varësinë e vajtueshme të njerëzve të shkencës dhe të artit nga njerëzit me tituj të lartë. — *104.*

49 *Valdensët* — sekt fetar, që lindi në fund të shekullit XII midis shtresave të ulëta të qyteteve të Francës Jugore. Themeluesi i tij, sipas gojëdhënës, është tregtari nga Lioni Pier Vald. Valdensët predikonin të hequrit dorë nga pronësia, dënonin grumbullimin e pasurive nga kisha katolike dhe bënin thirrje për t'u kthyer në zakonet e krishterimit të hershëm. Herezia e valdensëve u përhap sidomos midis popullsisë fshatare të krahinave malore të Zvicrës Jugperëndimore dhe të Savojës, ku ajo kishte karakterin e mbrojtjes së mbeturinave të rendit të komunës primitive dhe të marrëdhënieve patriarkale. — *109.*

50 *Albigezët* — sekt fetar, pikëpamjet e të cilit u përhapën gjerësisht në shekujt XII-XIII në qytetet e Francës Jugore dhe të Italisë Veriore. Vatra kryesore e tij ishte qyteti

Albi në Francën Jugore. Albigezët, që ishin kundër riteve madhështore katolike dhe kundër hierarkisë kishtare, shprehnin në formë fetare protestën e popullsisë tregtare dhe zejtare të qyteteve të Jugut kundër feudalizmit. Me ta u bashkua fisnikëria e Francës Jugore, që donte t'i shekullarizonte tokat e kishës. Papa Inocenti III organizoi në vitin 1209 një kryqëzatë kundër albigezëve. Pas një lufte të gjatë dhe ndjekjesh të egra lëvizja e albigezëve u shtyp. — *109.*

51 *Predikuesi hungarez* ishte njëri nga udhëheqësit e kryengritjes fshatare të vitit 1251 në Francë (i së ashtuquajturës kryengritje të «barinjve»). — *109.*

52 *Kalikstinët* dhe *taboritët* — dy rryma në lëvizjen nacionalçlirimtare dhe të reformave husite në Çeki (gjysma e parë e shekullit XV), që drejtohej kundër fisnikërisë gjermane, Perandorisë Gjermane dhe kishës katolike. *Kalikstinët* (ose ata që kërkonin që për kungimin të mos përdorej vetëm buka, por edhe kelshëjti me verë), të cilët mbështeteshin në fisnikët dhe në byrgerët çekë, donin vetëm një reformë kishtare të moderuar dhe shekullarizimin e pronave të kishës. *Taboritët* (nga qyteti Tabor — qendër e lëvizjes) ishin krahu revolucionar demokratik i husitëve dhe pasqyronin në kërkesat e tyre aspiratat e masave fshatare dhe të shtresave të ulëta të qytetit për likuidimin e gjithë rendit feudal. Veprimtaria tradhtare e kalikstinëve kundër taboritëve u shfrytëzua nga kampi i reaksionit feudal për shtypjen e lëvizjes husite. — *110.*

53 Është fjala për kryengritjen fshatare më të madhe që plasi në Angli në pranverën dhe në verën e vitit 1381. Fshatarët kryengritës me ndihmën e çirakëve dhe të shtresave të ulëta të qytetit pushtuan Londrën, por, të demoralizuar nga vrasja e udhëheqësit të tyre Uot Tajler, u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre, duke u besuar premtimeve të mbretit Riçard II. Duke përfituar nga kjo, feudalët i qëruan hesapet egër-

sisht me pjesëmarrësit e kryengritjes. Por nga frika e një shpërthimi të ri ata u detyruan të plotësonin në praktikë disa kërkesa të fshatarëve. Në mënyrë të veçantë kjo kryengritje luajti një rol të ndjeshëm për heqjen e bujkrobërisë në Angli. — *111.*

54 *Flagelantët* (ose «ata që rrahin veten») — sekt fetar asketik, që u përhap në Evropë në shekujt XIII-XV. Flagelantët thoshin se, duke munduar veten, mund të lash mëkatet.

Lolardët (fjalë për fjalë — «ata që mërmërisin lutje») — sekt fetar në Angli dhe në vende të tjera të Evropës (lindi në shekullin XIV), me qëndrim shumë armiqësor ndaj kishës katolike. Përqafoi doktrinën e reformatorit anglez Uiklif, duke nxjerrë prej saj konkluzione më radikale dhe duke u ngritur në një formë mistike fetare kundër privilegjeve feudale. Shumë lolardë, midis të cilëve mbizotëronin njerëzit që rridhnin nga masat e popullit dhe përfaqësuesit e klerit të ulët, morën pjesë në kryengritjen e Uot Tajlerit në vitin 1381. Nga fundi i shekullit XIV lolardët u ndoqën egërsisht. — *111.*

55 *Hiliazm* (nga fjala greke «hilias» — mijë) — doktrinë fetare mistike mbi ardhjen e dytë të Krishtit dhe mbi vendosjen e një «mbretërie mijëvjeçare» të drejtësisë, të barazisë dhe të mirëqenies së përgjithshme. Besimet hiliastike lindën në periudhën e shpërbërjes së rendit skllavopronar mbi bazën e shtypjes dhe vuajtjeve të padurueshme të punonjësve, të cilët kërkonin një rrugëdalje në ëndrrat fantastike mbi shpëtimin. Këto besime u përhapën gjerësisht në kohën e krishterimit të hershëm, duke u ringjallur vazhdimisht në doktrinat e sekteve të ndryshme mesjetare. — *112.*

56 *Kredoja e Augsburgut* — një shtjellim i parimeve të luteranizmit, që iu paraqit në vitin 1530 perandorit Karl V në sejmin perandorak në Augsburg; ishte rezultati i përshtatjes së idealeve të byrgerëve që donin një «kishë që të

kushtonte lirë» (heqja e riteve plot madhështi, thjeshtësimi i hierarkisë kishtare etj.) pas interesave të princërve. Në vend të papës, kryetar i kishës shpallej princi sundimtar. Kredoja e Augsburgut nuk u pranua nga perandori. Lufta e princërve që kishin përqafuar reformën luterane kundër perandorit përfundoi në vitin 1555 me paqen fetare të Augsburgut, që i njohu çdo princi të drejtën për të caktuar sipas dëshirës së tij fenë e nënshtetasve të vet. — *115.*

57 Është fjala për parlamentin e përfaqësuesve të shteteve gjermane, që bënin pjesë në «Unionin gjerman» të krijuar nga Prusia. Ky parlament u mblodh në Erfurt nga 20 marsi deri më 29 prill të vitit 1850 dhe u mor me përpunimin e planeve të bashkimit të Gjermanisë nën hegjemoninë e Prusisë monarkiste reaksionare. Dështimi i planeve të Prusisë për bashkimin e Gjermanisë dhe shpërbërja e «Unionit gjerman» i dhanë fund ekzistencës së parlamentit të Erfurtit. — *116.*

58 Me këtë shprehje Luteri titulloi dhe nxori në maj të vitit 1525, në zjarrin e Luftës fshatare, një pamflet plot urrejtje kundër lëvizjes fshatare. — *118.*

59 Engelsi ka parasysh pikëpamjet e filozofit idealist gjerman Shtraus, si dhe të Fojerbahut, i cili në veprat e veta të para doli në çështjet e fesë si panteist. — *122.*

60 W. Zimmermann. «Allgemeine Geschichte des grossen Bauernkrieges». Th. II. Stuttgart, 1842, S. 75 (V. Cimerman. «Historia e përgjithshme e Luftës së madhe fshatare». Pj. II. Shtutgart, 1842, f. 75). — *125.*

61 Engelsi ka parasysh pamfletin e Myncerit, që doli në Mylhauzen në vitin 1524 me titull: «Ausgedrückte Entblössung des falschen Glaubens der ungetreuen Welt durchs Zeugnis des Evangelious Lucae, vorgetragen der elenden erbärmlichen Christenheit zur Erinnerung ihres Irrsals» («Për-

gënjeshtrim i hapët i besimit të rremë të botës së padrejtë në bazë të dëshmisë së Ungjillit sipas Llukait, që i është parashtruar krishterimit të mjerë dhe fatkeq për t'i kujtuar lajthimet e tij»). — *125.*

62 Sipas të dhënash të mëvonshme dhe më të sakta, Mynceri shkoi në fillim në qytetin perandorak Mylhauzen, prej nga u përzu në shtator të vitit 1524 për pjesëmarrje në trazirat e shtresave të ulëta të qytetit. Nga Mylhauzeni Mynceri shkoi në Nyremberg. — *128.*

63 Përgjigjja që Mynceri i dha Luterit dhe që u botua në vitin 1524 mbante titullin: «Hoch verursachte Schutzrede und Antwort wider das geistlose, sanftlebende Fleisch zu Wittenberg, welches mit verkehrter Weise durch den Diebstahl der heiligen Schrift die erbärmliche Christenheit also ganz jämmerlich besudelt hat» («Një mbrojtje e argumentuar mirë dhe përgjigje trupit të Vitenbergut që jeton në bollëk dhe që me shtrembërimet dhe me falsifikimet e ulëta të shkrimeve të shenjta e ka përlyer në mënyrën më të turpshme krishterimin e mjerë»). — *128.*

64 Engelsi ka parasysh librin: Ch. Forster. «The historical geography of Arabia». Vol. 1-2, London, 1844 (Ç. Forster. «Gjeografia historike e Arabisë». Vëllimet 1-2. Londër, 1844). — *131.*

65 *Kurani* — «libri i shenjtë» kryesor i islamizmit, që përmban gjithfarë legjendash dhe mitesh, shtjellimin e besimit, rregulla morale, si dhe rregulla jetese dhe norma juridike. Kleri mysliman thotë se autori i gjithë këtij libri është Muhameti, gjë që hidhet poshtë nga shkenca e sotme, e cila ka provuar se pjesët e ndryshme të tij janë shkruar në kohë të ndryshme nga autorë të ndryshëm. — *133.*

66 Kisha *«e lartë»* dhe kisha *«e ulët»* — dy rryma rivale në kishën anglikane; e para kishte përkrahës kryesisht midis aristokracisë, luftonte për zbatimin e rreptë të riteve të vjetra plot madhështi, theksonte lidhjen me katolicizmin si vazhdim i tij; rryma e dytë u përhap kryesisht në radhët e klerit të ulët dhe të borgjezisë, të cilët nuk u jepnin rëndësi riteve të jashtme dhe i jepnin më tepër rëndësi predikimit fetar në frymën e moralit hipokrit të krishterë borgjez. — *140.*

67 Është fjala për përfaqësuesit e sekteve dhe të rrymave fetare të Anglisë, që kishin hequr dorë, kush më shumë e kush më pak, nga dogmat e kishës anglikane zyrtare. — *140.*

68 Pjesët e vëllimit të parë të «Kapitalit» (Tiranë 1970), që janë dhënë këtu, janë marrë nga kapitulli I (f. 115-118, lib. 1), si dhe nga shënimet e Marksit për kapitullin XIII (shënimi 89, f. 86, lib. 2) dhe për kapitullin XXIII (shënimi 75, f. 77-78, lib. 3). — *149.*

69 *Materializmi i shkencave natyrore* — «bindje spontane, e pavetëdijshme, e papërcaktuar, e pandërgjegjshme nga pikëpamja filozofike e shumicës së shkencëtarëve natyralistë për realitetin objektiv të botës së jashtme, që pasqyrohet nga ndërgjegjja jonë» (Lenin). E meta e këtij materializmi spontan shfaqet, veçanërisht, në faktin se shkencëtarët natyralistë, duke shkuar përtej caqeve të specialitetit të tyre të ngushtë, bien viktima të idealizmit dhe të metafizikës, në qoftë se ata nuk janë bërë materialistë të ndërgjegjshëm, përkrahës të materializmit dialektik. — *151.*

70 *«Kulturkampf»* («lufta për kulturën») — lufta që i bëri Bismarku në vjetët 1870-1880 partisë gjermane të katolikëve, partisë së «qendrës», duke ndërmarrë ndjekje policore kundër katolicizmit. Me këtë luftë Bismarku donte të dobësonte partikularizmin e Gjermanisë Jugore, përfaqësuese e të cilit ishte bërë partia katolike. Në të vërtetë

ai me këtë luftë nuk bëri tjetër veçse e forcoi klerikalizmin agresiv të kishës katolike dhe dëmtoi çështjen e kulturës së vërtetë. Në fund të dhjetëvjetëshit 1870-1880 Bismarku pranoi të afrohej me kishën katolike për të luftuar së bashku kundër lëvizjes punëtore socialiste. — *157.*

71 Marksi kritikon këtu udhëheqjen e socialdemokracisë gjermane, e cila në programin e paraqitur prej saj nuk e kishte theksuar me vendosmërinë e duhur qëndrimin armiqësor që mban partia punëtore ndaj opiumit fetar, por u kufizua vetëm të përsëriste kërkesën e «lirisë së ndërgjegjes», që ishte ngritur vazhdimisht nga partitë borgjeze. — *158.*

72 Shih F. Engels. «Anti-Dyring», bot. shqip, 1974, f. 115-116, 361-364, 394-395 dhe 397-398. — *159.*

73 Është fjala për ligjet që shpalli Bismarku në maj të vitit 1873 në kohën e «kulturkampfit» e që drejtoheshin kundër kishës katolike. Shih shënimin 70. — *164.*

74 Është fjala për librin e Kopernikut: «De revolutionibus orbium coelestium». 1543 («Mbi rrotullimin e sferave qiellore». 1543), në të cilin është paraqitur teoria heliocentrike. Sipas kësaj teorie, qendra e sistemit tonë planetar nuk është Toka, siç kujtonin më parë, por Dielli; Toka, duke u rrotulluar rreth Diellit, rrotullohet në të njëjtën kohë edhe rreth boshtit të vet. — *170.*

75 Matematikani i madh i Greqisë së Vjetër Euklidi, krijoi «Elementet e gjeometrisë», që është i pari shtjellim sistematik i gjithë gjeometrisë, i mbështetur në aksioma të përcaktuara plotësisht. «Elementet» e Euklidit kanë qenë për një kohë të gjatë e vetmja bazë mbi të cilën mbështetej gjeometria në të gjithë botën. — *170.*

76 Sipas të ashtuquajturit sistem gjeocentrik të astronomit grek, Ptolemeut, qendra e gjithësisë është Toka. Kjo teori

përbënte bazën e pikëpamjes fetare të gjithësisë. Në astronomi kjo teori mbeti në fuqi derisa Koperniku bëri zbulimin e vet të madh. — *170.*

77 *Alkimi* — kështu quheshin në mesjetë kërkimet që bëheshin për shndërrimin e metaleve të zakonshme në metale të çmueshme (ar, argjend) me ndihmën e njëfarë «guri filozofik» që nuk ekziston në natyrë. Gjatë këtyre kërkimeve të kota u zbuluan padashur një sërë lëndësh që u shfrytëzuan më vonë nga kimia. — *170.*

78 Është fjala për teorinë që sundoi në kimi në shekujt XVII-XVIII, sipas së cilës procesi i djegies shkaktohet nga një lëndë e veçantë që ekziston në trupat — nga flogjistoni. Studimet e M. V. Lomonosovit dhe të Lavuaziesë provuan se teoria e flogjistonit nuk kishte asnjë bazë. — *171.*

79 Hipoteza e prejardhjes së trupave qiellorë nga nebuloza të zjarrta. — *176.*

80 Engelsi nuk e dinte se shumë kohë para Majerit, Xhoullit dhe Grovit shkencëtari gjenial rus M. V. Lomonosov kishte përcaktuar parimin e përgjithshëm të ruajtjes së materies dhe të lëvizjes. Mendimet e veta mbi «ligjin e përgjithshëm natyror» të ruajtjes së materies dhe të lëvizjes, që përfshin «të gjitha ndryshimet që ndodhin në natyrë», Lomonosovi i paraqiti në letrën që i dërgoi L. Ejlerit (1748) dhe në «Arsyetimet mbi gjendjen e ngurtë dhe të lëngët të trupave» (v. 1760). — *177.*

81 *Amfioksi* — kafshë e vogël (rreth 5 cm. e gjatë) në trajtë peshku, e cila rron në shumë dete dhe oqeane (në Oqeanin Indian, në Oqeanin Paqësor, në brigjet e arkipelagut të Malajës dhe të Japonisë, në detin Mesdhe, në Detin e Zi etj.) dhe përfaqëson një formë kalimtare nga kafshët jovertebrore në vertebroret.

Lepidosireni — kafshë që hyn në rendin e peshqve me

mushkëri ose të peshqve që marrin frymë edhe me mushkëri edhe me verza; rron në Amerikën Jugore dhe në një varg vendesh të tjera. — *179.*

82 *Ceratodis* — peshk që merr frymë edhe me mushkëri edhe me verza, rron në Australi.

Arkeopteriksi — kafshë vertebrore fosile që është zhdukur dhe që është përfaqësuesja më e lashtë e klasës së shpendve dhe ka në të njëjtën kohë disa tipare të zvarranikëve. — *179.*

83 Engelsi, me sa duket, ka parasysh thëniet e Hekelit se qeniet e gjalla më të thjeshta, që ka studiuar ai dhe që ai i ka quajtur «monere», janë grumbuj albumine krejt pa strukturë dhe megjithatë kryejnë të gjitha funksionet kryesore të jetës. Shih Haeckel. «Generelle Morphologie der Organismen». Band I. Berlin, 1866, S. 133-136 (Hekel. «Morfologjia e përgjithshme e organizmave». Vëll. I, Berlin, 1866, f. 133-136). — *183.*

84 *Eozoon canadense* — shtresa minerale të gjetura në depozitimet e periudhës parakembrione të Kanadasë dhe që janë konsideruar si mbeturina të organizmave primitivë më të lashtë. Në vitin 1878 Mëbljusi e hodhi poshtë mendimin se ky mineral ka origjinë organike. — *183.*

85 Fjalë të Mefistofelit në «Faustin» e Gëtes (pjesa I, skena 3). — *186.*

86 Engelsi përmend këtu fjalët e astronomit italian A. Seki nga botimi gjermanisht i librit të tij «Die Sonne» («Dielli»), që doli në Braunshvajg në vitin 1872. — *187.*

87 *Barataria* (nga fjala spanjolle «barato» — «i lirë», me çmim të lirë) — emër qesharak i ishullit përrallor në romanin e Servantesit «Don Kishoti», guvernatori i të cilit ishe Sanço Pançoja. — *195.*

88 *Taliumi* u zbulua nga Kruksi në vitin 1861.

Radiometër — aparat për matjen e intensitetit të rrezatimit, i ndërtuar nga Kruksi në vjetët 1873-1874. — *200.*

89 Është fjala për «Komisionin për studimin e fenomeneve të mediumit», që u ngrit nga shoqëria e fizikës pranë Universitetit të Peterburgut më 6 maj 1875 dhe që u dha fund punimeve më 21 mars 1876. Ky komision kërkoi nga personat që përhapnin spiritizmin në Rusi, — Aksakovi, Butlerovi etj., t'i jepnin të dhëna mbi fenomenet «e vërteta» spiritike. Në këtë komision bënin pjesë shkencëtarët: D. I. Mendelejev, Bobilev, Krajeviç etj. Komisioni erdhi në përfundimin se «fenomenet spiritike rrjedhin nga lëvizje të pavetëdijshme ose nga një mashtrim i vetëdijshëm, ndërsa teoria spiritike është bestytni», dhe i botoi konkluzionet e veta në gazetën «Gollos» Nr. 85 të 25 marsit 1876. Materialet e komisionit u botuan nga D. I. Mendelejevi me titullin: «Materiale për të gjykuar mbi spiritizmin». Peterburg, 1876. — *203.*

90 Nga libreti i operës së Mozartit «Fyelli magjik» (akti I, skena 18). — *205.*

91 Engelsi e ka fjalën për sulmet reaksionare kundër darvinizmit, që shpërthyen në Gjermani, sidomos pas Komunës së Parisit të vitit 1871. Edhe një shkencëtar kaq i madh si Virhovi, dikur përkrahës i darvinizmit, më 1877 kërkoi që të ndalohej dhënia e mësimit të darvinizmit, duke thënë se darvinizmi është i lidhur ngushtë me lëvizjen socialiste dhe prandaj është i rrezikshëm për rendin shoqëror ekzistues. — *205.*

92 Më 18 korrik 1870 koncili i Vatikanit shpalli dogmën e «pagabueshmërisë» së papës. Teologu katolik gjerman Dëlinger nuk e pranoi këtë dogmë. Peshkopi i Majnit Keteler në fillim ishte gjithashtu kundër shpalljes së kësaj dogme të

re, por shumë shpejt e pranoi atë dhe u bë mbrojtësi i saj i flaktë. — *207.*

93 Këto fjalë janë marrë nga letra që natyralisti anglez T. Heksli i dërgoi «Shoqërisë logjike» («Dialectical Society») të Londrës, e cila e kishte ftuar të merrte pjesë në punimet e komitetit për studimin e fenomeneve spiritike. Heksli nuk e pranoi këtë ftesë dhe bëri një sërë vërejtjesh ironike mbi spiritizmin. Letra e Hekslit, që mban datën 29 janar 1869, u botua në gazetën «Daily News» të datës 17.X.1871. Ajo përmendet edhe në librin e mësipërm të Devisit «Londra mistike» (1875) në f. 389. — *207.*

94 Shënimet dhe fragmentet që janë dhënë këtu janë marrë nga libri i F. Engelsit «Dialektika e natyrës». Tiranë, 1973, f. 220-224 dhe 229-231. — *209.*

95 Shih shënimin 74. — *210.*

96 *«Sire, je n'avais pas besoin de cette hypothèse»* («Madhëri, unë nuk kisha nevojë për këtë hipotezë») — kështu iu përgjigj Laplasi Napoleonit I, që e pyeti përse nuk e përmend perëndinë në «Mekanikën qiellore» të tij. — *212.*

97 Engelsi ka parasysh fjalimin që mbajti Tindali në mbledhjen e Shoqatës shkencore britanike në Belfast më 19 gusht 1874 (është botuar në revistën «Nature» të 20 gushtit 1874). — *213.*

98 Heronj të romanit të Prevoit «Histoire du chevalier des Grieux et de Manon Lescaut» («Historia e kalorësit Degrijë dhe e Manon Leskosë») që doli në Paris më 1733. — *213.*

99 *Ignorantia non est argumentum* (padija nuk është argument). Për padijen, si i vetmi argument që përdorin përfaqësuesit e pikëpamjes teologjike klerikale mbi natyrën, Spinoza flet në shtojcën e pjesës së parë të «Etikës». — *214.*

100 Engelsi ka parasysh vjershën e Hajnes «Perëndia Apollon» («Der Apollgott»). — *218.*

101 *Shkolla e Tybingenit* — shkolla e studiuesve dhe e kritikëve të biblës, e themeluar nga F. Baueri në gjysmën e parë të shekullit XIX. Kritika racionaliste e ungjillit nga pasuesit e kësaj shkolle dallohet për mungesë konsekuence dhe nga dëshira për të ruajtur disa teza të biblës, si historikisht të vërteta. Padashur këta sudiues ndihmuan shumë që autoriteti i biblës, si burim i saktë, të binte. — *228.*

102 Shih K. Marks e F. Engels. Vepra të zgjedhura, bot. shqip, 1975, vëll. I, f. 377. — *236.*

103 Engelsi ka parasysh shënimet e Hajnes mbi «revolucionin filozofik gjerman» në studimin e shkruar prej tij në vitin 1833, «Rreth historisë së fesë dhe të filozofisë në Gjermani». — *240.*

104 Është fjala për librin: M. Stirner. «Der Einzige und sein Eigenthum». Leipzig, 1845 (M. Shtirner. «I vetmi dhe prona e tij». Lajpcig, 1845). — *249.*

105 Shih shënimin 40. — *249.*

106 Shih botimin shqip, 1976. — *249.*

107 Është fjala për planetin Neptun, që u zbulua në vitin 1846 nga astronomi gjerman Johan Gale. — *254.*

108 Është fjala për orvatjen e Robespierit për të ngritur kultin e «qenies supreme». — *266.*

109 Shprehje e përhapur në publicistikën borgjeze gjermane pas fitores së prusianëve pranë Sadovës (në luftën austro-prusiane të vitit 1866), sipas kuptimit të së cilës Prusia fitoi

gjoja në saje të epërsisë së sistemit prusian të arsimit popullor. — *271.*

110 *Radamant* — figura e gjykatësit të pamëshirshëm në mitologjinë e vjetër greke. — *272.*

111 *Albigezët* — shih shënimin 50. — *292.*

112 Term i përdorur për të treguar Perandorinë Gjermane (pa Austrinë), që lindi në vitin 1871 nën hegjemoninë e Prusisë. — *295.*

113 Është fjala për veprën e F. Engelsit «Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit». — *302.*

114 Është fjala për librin: W. Wachsmuth. «Hellenische Alterthumskunde». Halle, 1826-1830 (V. Vaksmut. «Lashtësitë helene». Hale, 1826-1830). — *303.*

115 Shih K. Marks. «Kapitali», bot. shqip, vëll. I, lib. 1, kap. VIII, f. 310-406. — *316.*

116 Është fjala për librin: P. Barth. «Die Geschichtsphilosophie Hegel's und der Hegelianer bis auf Marx und Hartmann». Leipzig, 1890 (P. Bart. «Filozofia e historisë së Hegelit dhe të hegelianëve deri te Marksi dhe Hartmani inkluzivisht». Lajpcig, 1890). — *316.*

117 *«Vorwärts»* («Përpara») — organi qendror i socialdemokracisë gjermane pas Kongresit të bashkimit të Gotës; dilte në Lajpcig në vjetët 1876-1878. — *320.*

118 *Marka* — komuna e vjetër gjermane. Me titullin «Marka» Engelsi dha në një shtojcë të botimit të parë gjermanisht të veprës së vet «Zhvillimi i socializmit nga utopia në shkencë» një studim të shkurtër të historisë së fshatarësisë gjermane që nga kohët e lashta. — *320.*

119 *Agnosticizëm* — (nga fjalët greke: *a* — jo, *gnosis* — njohje) — rrymë në filozofi, e cila e quan të pamundshme njohjen e realitetit objektiv dhe, si rrjedhim, mohon të vërtetën objektive. Në kuadrin e agnosticizmit ka ndryshime, veçanërisht, midis Kantit që pranon ekzistencën e botës objektive, «të sendeve në vetvete», që nuk mund të njihen nga ne, dhe Hjumit, që vë në dyshim ekzistencën e botës objektive. Por si njëri ashtu dhe tjetri mohojnë realitetin objektiv si burim të ndijimeve dhe të perceptimeve tona. Sot agnosticizmi ka dalë sheshit si një variant i filozofisë idealiste reaksionare, i cili lufton kundër njohjes shkencore të ligjeve të natyrës dhe të zhvillimit të shoqërisë. — *322.*

120 Shih K. Marks e F. Engels. «Familja e shenjtë», bot. shqip, f. 187-189. — *325.*

121 *Kisha zyrtare anglikane e Anglisë* — lindi në shekullin XVI gjatë luftës së mbretërve anglezë kundër papës së Romës. Kreu i kishës quhej mbreti. Nga fillimi i shekullit XVII përkrahu vazhdimisht rrymat konservatore në jetën politike të Anglisë. — *326.*

122 *Ushtria e shpëtimit* — organizatë filantropike reaksionare e krishterë borgjeze, që u themelua në vitin 1865 nga prifti Buts në Londër për t'u dhënë të ashtuquajturën ndihmë «shpirtërore» dhe materiale të varfërve. Një nga detyrat e saj kryesore ishte predikimi i moralit fetar dhe propaganda reaksionare për të errësuar ndërgjegjen e masave të popullit. Ka organizatat e veta në SHBA dhe në shumë vende të tjera kapitaliste, veçanërisht në kolonitë, ku ndihmon për zbatimin e politikës koloniale. Është e organizuar në mënyrë ushtarake. Ajo është vegël në duart e borgjezisë reaksionare, që drejtohet kundër lëvizjes punëtore dhe demokratike. — *326.*

123 Është fjala për veprën e P. S. Laplasit «Traité de mécanique céleste...». Vol. I-V. Paris, 1799-1825. — *327.*

124 Të ashtuquajturat ligje të drithit, që kishin për qëllim të kufizonin ose të ndalonin importimin e drithit nga jashtë, u vunë në Angli për të mbrojtur interesat e lendlordëve (të pronarëve të mëdhenj të tokave). Lufta midis borgjezisë industriale dhe aristokracisë së tokës për shkak të ligjeve të drithit përfundoi në vitin 1846 me bilin që shpalli heqjen e tyre. — *340.*

125 *«Vëlla Xhonatani»* — kështu i quanin Shtetet e Bashkuara të Amerikës. — *341.*

126 *Revivalizëm* — lëvizje fetare, e cila u orvat të forconte ndikimin e fesë, që po dobësohej. — *341.*

127 *Almoravidët* — dinasti feudale berbere e shekujve XI-XII në Afrikën Veriore dhe në Spanjën Jugore.

Almohadët — dinasti feudale berbere e shekujve XII--XIII, e cila në vitin 1146 përmbysi dinastinë e almoravidëve.

Mahdiu nga Hartumi — Muhamed Ahmedi (rreth 1844--1885), udhëheqës i kryengritjes popullore në Sudanin Lindor (1881-1885). Kjo kryengritje e fshatarëve dhe e nomadëve ishte drejtuar kundër kolonizatorëve anglezë dhe kolonizatorëve të tjerë evropianë dhe përfundoi me përzënien e tyre të përkohshme (deri në vitin 1898) nga ky vend. — *352.*

128 E. Renan «Histoire des origines du christianisme». Vol. 1-8. Paris, 1863-1883 (E. Renan. «Historia e prejardhjes së krishterimit». Vëll. 1-8, Paris, 1863-1883). — *353.*

129 Është fjala për veprën e Komodianit «Carmen apologeticum adversus Judaeos et gentes» («Këngë apologjetike drejtuar judejve dhe paganëve»). — *361.*

130 *Kabala* — doktrinë mistike fetare, e lidhur me magjinë; ishte e përhapur midis judejve. — *361.*

131 *Gnostikët* — rrymë mistike fetare e periudhës së krishterimit të hershëm; në filozofi ajo ishte një rrymë eklektike reaksionare. Duke qenë armiq të tërbuar të materializmit të lashtë grek, gnostikët u hapnin rrugën obskurantistëve mesjetarë. — *362.*

132 *Zendavesta* (sak: Avesta) — përmbledhje «librash të shenjtë» të fesë së zoroastrizmit, të përhapur në Persinë e Vjetër, në Azerbajxhan dhe në Azinë e Mesme; mendohet të jetë krijuar nga shekulli IX para erës sonë deri në shekullin III të erës sonë. — *380.*

133 J. Ph. Falmmerayer. «Geschichte der Halbinsel Morea während des Mittelalters». Stuttgart und Tübingen; erster Theil — 1830, zweiter Theil — 1836 (J. F. Falmerajer. «Historia e gadishullit të Moresë në mesjetë». Shtutgart dhe Tybingen; pjesa e parë — 1830, pjesa e dytë — 1836). — *381.*

134 *Hebraizëm* — fjalë ose shprehje, që është veçori e hebraishtes së vjetër. — *382.*

TREGUESI I EMRAVE

A

Adriani (76-138) — perandor romak (117-138). — 360.

Agasis (Agassiz), Lui Zhan Rudolf (1807-1873) — natyralist zviceran, përkrahës i botëkuptimit reaksionar idealist, armik i darvinizmit dhe mbrojtës i idesë së «krijimit hyjnor». — 211, 213.

Agostini (i mbiquajtur «i lumë») (354-430) — teolog dhe filozof idealist i krishterë, predikues i zjarrtë i botëkuptimit fetar. — 36.

Albreht (Albrecht), Karl (1788-1844) — një nga pasuesit e Vajtlingut; predikonte socializmin e krishterë në Zvicër. — 355-356.

Aleksandri i Maqedonisë (356-323 para erës sonë) — strateg dhe burrë shteti i famshëm i botës së lashtë. — 22, 370.

Anaksagora nga Klazomeni (Azia e Vogël) (rreth 500-428 para erës sonë) — filozof materialist i Greqisë së Vjetër; u akuzua për ateizëm dhe u përzu nga Athina. — 67.

Antioku IV Epifan — mbret sirian (175-164 para erës sonë) nga dinastia e Seleukidëve. — 362.

Antonin Piu (86-161) — perandor romak (138-161). — 360.

Apiani (fundi i shek. I — dhjetëvjetëshi i tetë i shek. II) — historian i shquar i Romës së Vjetër. — 290.

Aristoteli (384-322 para erës sonë) — mendimtar i madh i kohës së lashtë; në filozofi lëkundej midis materializmit dhe idealizmit; ideolog i klasës së skllavopronarëve. — 22, 40.

Arkrajt (Arkwright), Riçard (1732-1792) — sipërmarrës borgjez anglez i periudhës së revolucionit industrial; përvetësoi një sërë patentash të shpikjeve të bëra prej të tjerëve në Angli. — 339.

Arno (Arnauld), Antuan (1612-1694) — filozof francez, përkrahës i teorisë idealiste të njohjes të Dekartit, metafizikan. — 66.

Arnoldi nga Breshia (rreth 1100-1155) — reformator mesjetar italian, ideolog i lëvizjes së shtresave të ulëta të qytetit kundër papës dhe feudalëve klerikalë në Romë dhe në qytete të tjera; u ekzekutua si heretik. — 109, 110.

Aston, Luiza (1814-1871) — shkrimtare gjermane me tendenca demokratike mikroborgjeze. — 98.

Auerbah (Auerbach), Bertold (1812-1882) — shkrimtar gjerman me tendenca liberale, më vonë apologjet i Bismarkut. — 98, 101.

Augusti (63 para erës sonë — 14 të erës sonë) — perandor romak (27 para erës sonë — 14 të erës sonë). — 217, 218.

Aurangzeb (1618-1707) — sundimtar feudal indian (1658-1707) nga dinastia e Mogolëve të Mëdhenj. — 134.

B

Babëf (Babeuf), Grakh (emri i tij i vërtetë ishte Fransua Noel) (1760-1797) — revolucionar francez, përfaqësues i shquar i komunizmit barazimtar, utopik, organizator i komplotit të «të barabartëve». — 165.

Baklent (Buckland), Uiliam (1784-1856) — gjeolog anglez; ishte njëkohësisht edhe kryeprift i katedrales së Uestminsterit. — 325.

Bakunin, Mihail Aleksandroviç (1814-1876) — ideolog i anarkizmit, armik i tërbuar i marksizmit. — 248, 274.

Barbon, Nikolla (rreth 1640-1698) — mjek anglez, ekonomist borgjez, një nga paraardhësit e ekonomisë politike klasike borgjeze. — 153.

Bart (Barth), Paul (1858-1922) — sociolog borgjez gjerman, që ka luftuar kundër marksizmit. — 316.

Baur, Ferdinand Kristian (1792-1860) — teolog gjerman, drejtuesi i shkollës së Tybingenit, profesor në Tybingen. — 228.

Bauer, Bruno (1809-1882) — filozof idealist gjerman, një nga hegelianët e rinj më të shquar, radikal borgjez, kritik i biblës, autor i disa veprave mbi historinë e krishterimit të hershëm. — 33, 85, 215, 216, 217, 219, 220, 248, 250, 274, 359, 360, 382.

Bejl (Bayle), Pier (1647-1706) — filozof skeptik francez, që luftonte kundër metafizikës, dogmave kishtare dhe paragjykimeve fetare. — 66, 294.

Beker (Becker), August (1814-1871) — publicist gjerman, në vjetët 1840-1850 ishte një nga udhëheqësit e vajtlingianëve të Zvicrës. — 356.

Bekon (Becon), Frensis, baron i Verulamit (1561-1626) — filozof i shquar anglez, themelues i materializmit anglez; natyralist dhe historian. — 39, 68-69, 193, 322-325.

Benari (Benary), Ferdinand (1805-1880) — filolog orientalist gjerman dhe studiues i biblës, profesor në Berlin. — 232, 234, 375, 377, 379.

Bengel, Joan Albreht (1687-1752) — teolog protestant gjerman. — 379.

Bentam (Bentham), Jeremia (1748-1832) — sociolog borgjez anglez, teoricien i utilitarizmit. — 72.

Ber, Karl Maksimoviç (1792-1876) — akademik rus, themelues i embriologjisë shkencore. — 180, 212.

Bernshtajn (Bernstein), Eduard (1850-1932) — socialdemokrat gjerman; pas vdekjes së Engelsit u bë renegat dhe kërkoi të revizionontе marksizmin. — 316.

Bernje (Bernier), Fransua (1625-1688) — mjek dhe udhëtar francez. — 134, 136, 139.

Bertlo (Berthelot), Marselen (1827-1907) — kimist i madh francez, autor i disa veprave mbi sintezën e lëndëve organike dhe mbi historinë e kimisë. — 265.

Bëme (Böhme), Jakov (1575-1624) — zejtar gjerman, filozof mistik; në sistemin e tij kishte disa elemente të dialektikës — 23, 67, 323.

Bismark (Bismarck), Oto (1815-1898) — kryeministër prusian, nga viti 1871 kancelari i parë i Perandorisë Gjermane. — 157, 163-164.

Blan (Blanc), Lui (1811-1882) — socialist dhe historian mikroborgjez francez, figurë e shquar e revolucionit të vjetëve 1848-1849, që qëndronte në pozitat e pajtimit me borgjezinë. — 265.

Bloh (Bloch), Josif (lindi më 1871) — redaktor i revistës «Sozialistische Monatshefte». — 302.

Bokaço (Boccaccio), Xhovani (1313-1375) — novelisti dhe satiriku më i madh italian i epokës së Rilindjes, i njohur për antiklerikalizmin e tij. — 110.

Bolingbrok (Bolingbroke), Henri (1678-1751) — filozof deist dhe personalitet politik anglez, një nga krerët e partisë tori. — 336.

Boll (Ball), Xhon (vdiq në vitin 1381) prift anglez fshati; predikues popullor, një nga frymëzuesit e kryengritjes fshatare të Uot Tajlerit në Angli në vitin 1381. — 109, 111.

Brajt (Bright), Xhon (1811-1899) — fabrikant anglez, personalitet politik borgjez, fritreder, një nga themeluesit e Lidhjes kundër ligjeve të drithit; nga fundi i dhjetëvjetëshit 1860-1870 u bë një nga krerët e partisë liberale; ka qenë ministër në një sërë kabinetesh liberale. — 344.

Brentano, Lujo (1844-1931) — ekonomist borgjez gjerman, socialist i katedrës. — 347.

Brykneri (Bruckner), Xhon (1726-1804) — prift protestant anglez. — 153.

Bruno, Xhordano (1548-1600) — mendimtar i madh italian, materialist dhe ateist; zhvilloi teorinë e Kopernikut mbi ndërtimin e gjithësisë; u dogj nga inkuizicioni, sepse nuk pranoi të hiqte dorë nga idetë e tij. — 170, 209.

Byhner (Büchner), Ludvig (1824-1899) — mjek gjerman, popullarizues i shkencave të natyrës, përfaqësues i materializmit vulgar. — 257.

C

Cezar (Gaj Jul Cezari) (rreth 100-44 para erës sonë) — strateg i famshëm dhe burrë shteti romak. — 218.

Cëlner (Zöllner), Johan Karl Fridrih (1834-1882) — fizikan dhe astronom gjerman; përkrahës i spiritizmit. — 203-204.

Ciceroni (Mark Tul Ciceroni) (106-43 para erës sonë) — orator i shquar dhe burrë shteti romak, filozof eklektik. — 9, 22.

Ç

Çallmers (Chalmers), Tomas (1780-1847) — teolog protestant dhe ekonomist anglez, pasues i Maltusit. — 152, 155.

D

Dalton, Xhon (1766-1844) — kimist dhe fizikan i shquar anglez, zhvilloi idetë e atomistikës në kimi. — 178.

Darvin (Darwin), Çarls (1809-1882) — natyralist i madh anglez, themelues i teorisë së prejardhjes dhe të zhvillimit të llojeve të bimëve dhe të kafshëve; teoria e tij goditi për vdekje shpjegimet fetare dhe idealiste të natyrës. — 151, 180, 186, 194, 211, 260, 279, 319.

Daumer, Georg Fridrih (1800-1875) — shkrimtar gjerman, autor i disa veprave mbi historinë e fesë. — 97-105.

Defo (Defoe), Daniel (rreth 1660-1731) — shkrimtar dhe gazetar i dëgjuar borgjez anglez, që është marrë me çështjet e ekonomisë, të politikës, të historisë dhe të fesë; autor i romanit të famshëm «Robinson Kruzo». — 152.

Dekart (Descartes), Rene (1596-1650) — filozof dualist, matema-

tikan dhe natyralist i shquar francez. — 63-65, 69, 70-71, 171, 178, 255, 257.

Demokriti (rreth 460 - rreth 370 para erës sonë) — filozof materialist i madh i Greqisë së Vjetër, një nga themeluesit e teorisë atomistike. — 65, 67, 322.

Dezami (Dézamy), Teodor (1803-1850) — publicist francez, materialist, përfaqësues i shquar i rrymës revolucionare të komunizmit utopist. — 72.

Dëlinger (Döllinger), Ignac (1799-1890) — teolog gjerman, dikur kryesonte lëvizjen e katolikëve të vjetër gjermanë, të cilët nuk donin të pranonin dogmën e pagabueshmërisë së papës. — 207.

Didro (Diderot), Deni (1713-1784) — filozof i shquar francez, përfaqësues i materializmit mekanistik, ateist, një nga ideologët e borgjezisë revolucionare franceze, iluminist, kryetari i enciklopedistëve; për veprat e tij ateiste u burgos dhe u mbyll në një kështjellë. — 70, 262.

Dicgen (Dietzgen), Josif (1828-1888) — punëtor gjerman lëkurësh, socialdemokrat, filozof autodidakt, që arriti vetë në bazat e materializmit dialektik; armik i klerikalizmit dhe i agnosticizmit. — 277.

Dingelshtedt (Dingelstedt), Franc, baron (1814-1881) — poet dhe shkrimtar gjerman; në fillim ishte përfaqësues i poezisë politike të opozitës mikroborgjeze, nga mesi i dhjetëvjetëshit 1840-1850 u bë dramaturg i oborrit; ishte monarkist. — 98.

Dizraeli (Disraeli), Benxhamin, Konti Bikonsfild (1804-1881) — burrë shteti dhe shkrimtar anglez, udhëheqës i partisë konservatore, kryeministër (1868 dhe 1874-1880). — 344.

Doduell (Dodwell), Henri (vdiq më 1784) — filozof materialist anglez, që vuri në dyshim vërtetësinë e përmbajtjes së biblës dhe kritikoi legjendat mbi martirët e krishterë. — 69, 324.

Drejper (Draper), Xhon Uiliam (1811-1882) — fiziolog amerikan, kimist dhe historian liberal borgjez i kulturës, që demaskoi obskurantizmin kishtar. — 191.

Duns Skot (Duns Scotus), Johan (rreth 1265-1308) — filozof i kohës së mesjetës, skolastik, përfaqësues i nominalizmit, që ishte shprehja e parë e materializmit në mesjetë. — 67, 322.

Dypyi (Dupuis), Sharl Fransua (1742-1809) — iluminist borgjez francez; libri i tij mbi prejardhjen e kulteve fetare luajti një rol të madh në propagandën antifetare. — 70.

Dyrer (Dürer), Albreht (1471-1528) — piktor dhe gravurist, skulptor dhe arkitekt i madh gjerman, një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të kulturës së epokës së Rilindjes në Gjermani. — 169.

Dyring (Dühring), Eugen (1833-1921) — materialist vulgar gjerman, pozitivist, eklektik, ideolog i socializmit mikroborgjez reaksionar, armik i marksizmit. — 160, 161, 163, 318, 319, 320.

E

Ekerman (Eckermann), Johan Peter (1792-1854) — shkrimtar gjerman, autor dhe botues i «Bisedave me Gëten në vjetët e fundit të jetës së tij». — 98.

Engelhard, Magdalina Filipina (1756-1831) — poeteshë gjermane jo fort e njohur. — 99.

Epikuri (rreth 341 — rreth 270 para erës sonë) — filozof materialist i shquar i Greqisë së Vjetër dhe ateist. — 9, 10, 22, 65, 149, 218, 224.

Eskili (525-456 para erës sonë) — dramaturg i shquar i Greqisë së Vjetër, autor tragjedish klasike. — 48.

Eshli (Ashley), Antoni, nga viti 1851 kont Shefsberi (1801-1885) — personalitet politik anglez, tori. — 140-141.

Euklidi (fundi i shek. IV — fillimi i shek. III para erës sonë) — matematikan i shquar i Greqisë së Vjetër. — 170.

Evald (Ewald), Georg Henrih (1803-1875) — filozof gjerman, orientalist dhe teolog, studiues i biblës. — 218, 375.

F

Fihte (Fichte), Johan Gotlib (1762-1814) — filozof gjerman, idealist subjektiv, përfaqësues i idealizmit gjerman të fundit të shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX. — 39.

Filipi II (rreth 382-336 para erës sonë) — mbret i Maqedonisë (359-336 para erës sonë), i ati i Aleksandrit të Maqedonisë. — 370.

Filoni i Aleksandrisë (rreth 20 para erës sonë — rreth 54 të erës sonë) — përfaqësuesi kryesor i filozofisë fetare judeo-aleksandrine të fillimit të shekullit I, që ushtroi një ndikim shumë të madh mbi formimin e teologjisë së krishterë. — 217-218, 219, 230, 359-360.

Finlen, Xhejms — çartist, në vjetët 1852-1854 ishte anëtar i Komitetit ekzekutiv të Shoqatës çartiste kombëtare. — 144.

Flavët — dinasti perandorësh romakë (69-96). — 360.

Fogt (Vogt), Karl (1817-1895) - natyralist gjerman, materialist vulgar. — 257.

Fojerbah (Feuerbach), Ludvig (1804-1872) — një nga filozofët materialistë dhe ateistë më të mëdhenj të periudhës para Marksit, që ka kritikuar në mënyrë të shkëlqyer idealizmin dhe fenë, sidomos krishterimin. — 33, 34, 63, 66, 73-76, 236, 237, 249, 250-251, 254-261, 263-274, 316.

Forster, Uiliam (1819-1886) — fabrikant anglez, një nga krerët e partisë liberale. — 342, 344.

Franklin, Benxhamin (1706-1790) — shkencëtar i shquar dhe personalitet politik amerikan, pjesëmarrës i luftës për pavarësinë e kolonive angleze në Amerikën Veriore, ekonomist. — 152, 153.

Frederiku II (i mbiquajtur «i madh») (1712-1786) — mbret i Prusisë (1740-1786). — 161.

Frederik Vilhelmi III (1770-1840) — mbret i Prusisë (1797-1840). — 213, 240, 245.

Frederik Vilhelmi IV (1795-1861) — mbret i Prusisë (1840-1861). — 56, 91-92, 248.

Furje (Fourier), Sharl (1772-1837) — socialist utopist i madh francez. — 72, 300, 369.

G

Galba (Serv Sulpic Galba) (rreth 5 para erës sonë — 69 të erës sonë) — perandor romak (68-69). — 234, 376, 377, 378.

Gale (Galle), Johan Gotfrid (1812-1910) — astronom gjerman, i cili në vitin 1846 zbuloi planetin Neptun. — 254.

Galilei, Galileo (1564-1642) — fizikan dhe astronom i madh italian, krijues i bazave të mekanikës, luftonte për një botëkuptim përparimtar; në vitin 1633 u gjykua nga inkuizicioni për teorinë e tij të rrotullimit të Tokës rreth Diellit. — 210.

Gasendi (Gassendi), Pier (1592-1655) — filozof materialist i dëgjuar francez, përkrahës dhe propagandist i teorisë atomistike të Epikurit; e rehabilitoi këtë të fundit nga shpifjet e kishës së krishterë; fizikan dhe matematikan. — 9, 10, 65.

Gaterer (Gatterer) — shih *Engelhard,* Magdalina Filipina.

Gej (Gay), Zhul (1807 — pas 1876) — komunist utopist francez. — 72.

Georg (1471-1539) — dukë i Saksonisë (1500-1539); një nga organizatorët e masakrave kundër fshatarëve kryengritës në Turingi më 1525. — 127.

Gëres (Görres), Jozef (1776-1848) — shkrimtar gjerman i rrymës romantike reaksionare, filolog dhe historian, përkrahës i katolicizmit. — 37.

Gëte (Goethe), Johan Volfgang (1749-1832) — shkrimtar dhe mendimtar i madh gjerman. — 97, 98, 245, 259.

Gfrërer (Gfrörer), August Fridrih (1803-1861) — historian gjerman i krishterimit dhe i kishës, përfaqësues i shkollës së Tybingenit, profesor në Universitetin e Frajburgut. — 228.

Gibon (Gibbon), Eduard (1737-1794) — historian borgjez anglez, autor i veprës me shumë vëllime «Historia e rënies dhe e shkatërrimit të Perandorisë Romake», në të cilën u mundua të jepte një histori kritike të kishës së krishterë. — 131.

Gilani (Ghillany), Fridrih Vilhelm (1807-1876) — historian dhe teolog gjerman jo fort i dëgjuar. — 99.

Gizo (Guizot), Fransua Pier Gijom (1787-1874) — historian borgjez francez dhe burrë shteti, nga viti 1840 deri në vitin 1848 drejtoi në fakt politikën e brendshme dhe të jashtme, shprehte interesat e borgjezisë së madhe financiare. — 285.

Grebel, Konrad — udhëheqës i sektit të anabaptistëve në Cyrih, pasues i Myncerit; bënte agjitacion revolucionar në Gjermaninë Jugore. — 129.

Groci (Grotius), Hugo (1583-1645) — shkencëtar holandez, jurist, një nga themeluesit e teorisë borgjeze të së drejtës natyrore. — 39.

Grov (Grove), Uiliam Robert (1811-1896) — jurist dhe fizikan anglez. — 177, 211.

Grovnor (Grosvenor), Robert (1801-1893) — aristokrat anglez, i përkiste krahut të djathtë të vigëve. — 142, 148.

Gryn (Grün), Karl (1817-1885) — publicist mikroborgjez gjerman, nga mesi i dhjetëvjetëshit 1840-1850 ishte një nga përfaqësuesit kryesorë të «socializmit të vërtetë». — 250.

Guckov (Gutzkow), Karl (1811-1878) — shkrimtar gjerman, një nga përfaqësuesit e grupit letrar «Gjermania e Re»; në vjetët 1838-1842 ishte redaktor i revistës «Telegraph für Deutschland». — 99.

Guld (Gould), Xhej (1836-1892) — financier amerikan, milioner. — 310.

Gj

Gjergji IV (1762-1830) — mbret i Anglisë (1820-1830). — 142.

H

Hafiz, Shamsedin Mohamed (rreth 1300 — rreth 1389) — një nga poetët më të mëdhenj persianë, klasik i letërsisë taxhike; me origjinë taxhike. — 101.

Hajne (Heine), Henrih (1797-1856) — poet i madh revolucionar gjerman. — 218, 240, 369.

Hartli (Hartley), David (1705-1757) — mjek anglez, filozof materialist. — 324.

Hegel, Georg Vilhelm Fridrih (1770-1831) — një nga filozofët më të mëdhenj gjermanë — idealist objektiv, përpunoi në mënyrën më të gjithanshme dialektikën idealiste. — 10, 33, 39, 51, 63, 70, 122, 215, 236-247, 251-256, 258, 262, 267-269, 274-278, 281, 283, 287, 315, 317, 328.

Heksli (Huxley), Tomas Henri (1825-1895) — natyralist anglez, bashkëpunëtori më i afërt i Ç. Darvinit dhe popullarizues i teorisë së tij. — 207.

Helveci, Klod Adrian (1715-1771) — filozof i shquar francez, përfaqësues i materializmit mekanistik, ateist, një nga ideologët e revolucionit borgjez francez. — 66, 70-72.

Henriku VII (1457-1509) — mbret i Anglisë (1485-1509). — 335.

Henriku VIII (1491-1547) — mbret i Anglisë (1509-1547). — 334.

Herakliti (rreth 540 — rreth 480 para erës sonë) — filozof i shquar i Greqisë së Vjetër, një nga themeluesit e dialektikës, materialist spontan. — 40.

Hermes, Karl Henrih (1800-1856) — publicist reaksionar gjerman, në vitin 1842 ishte një nga redaktorët e «Kölnische Zeitung»; agjent i fshehtë i qeverisë prusiane. — 14-16, 21-30.

Hershel (Herschel), Uiliam (Fridrih Vilhelm) (1738-1822) — shkencëtar i shquar anglez në fushën e astronomisë dhe të optikës; me origjinë gjermane. — 175.

Hjum (Hume), David (1711-1776) — filozof anglez, idealist su-

bjektiv, agnostik; historian dhe ekonomist borgjez, shquhej për skepticizmin e tij dhe për mendimet e lira në çështjet e fesë. — 11, 153, 154-155, 253, 254.

Hobs (Hobbes), Tomas (1588-1679) — filozof i shquar anglez, përfaqësues i materializmit mekanistik; pikëpamjet politike dhe shoqërore të Hobsit ishin çliruar nga ndikimi fetar, por dalloheshin për tendenca të theksuara antidemokratike. — 39, 65, 68, 69, 92, 153, 255, 323-324, 325, 336.

Holbah (Holbach), Pol Anri (1723-1789) — filozof i shquar francez, përfaqësues i materializmit mekanistik, një nga ideologët e borgjezisë revolucionare franceze, autor i shumë librave dhe broshurave, që kritikojnë ashpër fenë dhe kishën dhe predikojnë ateizmin. — 70.

Horn (Horne), Xhorxh (1730-1792) — peshkop anglikan. — 154.

Hubmajer (Hubmaier), Baltazar (vdiq më 1528) — pasues i Myncerit dhe predikues i reformës popullore, një nga frymëzuesit e kryengritjes së fshatarëve dhe të qytetarëve në Shvarcvald; u dogj mbi zgjarr më 1528. — 129.

Humboldt, Aleksandër (1769-1859) — natyralist i shquar gjerman. — 212.

Hus, Jan (rreth 1369-1415) — reformator i shquar çek, profesor i Universitetit të Pragës, frymëzues i lëvizjes nacionalçlirimtare çeke; u akuzua si heretik dhe u dogj mbi zjarr. — 110.

Hyten (Hutten), Ulrih fon (1488-1523) — poet humanist gjerman, përkrahës i reformës, kundërshtar i flaktë i kishës së Romës, pjesëmarrës i kryengritjes së kalorësve të vjetëve 1522-1523 dhe ideolog i saj. — 115.

I

